

**UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНІВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY**



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

Katedra e Gjuhës dhe letërsisë Shqipe

PUNIM MAGJISTRATURE

LËMIA: LETËRSI SHQIPE

TEZA:

Qarku tematik në prozën e Bilal Xhaferit

Kandidatja:
Selxhan Selmani Ejupi

Mentori:
Prof. Dr. Hamit Xhaferi

Tetovë, 2020



Bilal Xhaferi - Shkrimtari disident i rrënjeve të etnisë shqiptare

Falënderim

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për mentorin Prof. dr. Hamit Xhaferi për udhëzimet, këshillat e vlefshme dhe mbështetjen e vazhdueshme gjatë finalizimit të këtij punimi.

Dua të falënderoj të gjithë profesorët e Universitetit të Evropës Juglindore, të cilët kontribuan në arritjen time. Gjithashtu, u jam mirënjohëse kolegëve dhe personave të tjerë të cilët në një mënyrë apo tjetër kontribuan në arritjen time deri këtu.

Këtë punim ia dedikoj familjes sime që pa mbështetjen dhe durimin e të cilëve nuk do të ishte e mundur të finalizohet kjo punë. Dëshiroj ta falënderoj dhe t'i shpreh mirënjohjen bashkëshortit tim për përkrahjen e tij të palodhshme, djalit tim për durimin dhe motivin.

Abstrakt

Bilal Xhaferi si një poet prozator dhe publicist i shquar në letërsinë shqipe, me një numër të vogël veprash të botuara pas vdekjes së tij, emërohet si një ndër krijuesit më të dalluar të shekullit XX. Disa nga veprat e tij janë:

“ Krastakraus “, “ Ra Berati “, “ Njerëz të rinj, tokë e lashtë “, “ Lirishta e kuqe “, “ Dashuri e përgjakur “, “ Trotuare të kundërt “, “ Hëna e kantierëve “, etj.

Qëllimi i këtij punimi është vepra e tij “ Krastakraus “ e cila tregon kohën gjatë luftës së epokës së Skënderbeut, dhe tradhëtia që i vjen qytetit të Beratit, pikërisht nga njerëzit e tij. Poashtu vlen të theksohet se ndiqeshte nga regjimi komunist i asaj kohe.

Gjithashtu në këtë punim të Masterit, i kushtohet analizë edhe veprës me tregime “ Njerëz të rinj, tokë e lashtë “, duke analizuar në veçanti personazhët e këtyre tregimeve që dalin të thjeshtë, bujarë dhe atdhedashës, që tek lexuesit përcjellin shembëlltyrën e njeriut real.

Në këtë punim masteri do të analizohen të gjitha ndjesitë e autorit se çfarë ka dashur ai të thotë me veprat e tij, qofshin në prozë apo në poezi.

Në periudhën e komunizmit jeta e tij sfidohet ashpër, ngjarjet e jetës do jenë shumë të vështira dhe në fund të detyrohet të arratiset drejt SHBA – së.

Fjalë kyçe: Krastakraus, Ra Berati, Tradhëtia, Analiza e personazheve, Profili poetik i Bilal Xhaferit etj.

Përmbajtja:

Hyrje

5

Kapitulli i parë

1.1 Qëllimet e punimit

9

1.2 Hipoteza

10

1.3 Metodologjia

11

Kapitulli II

2.1 Rëndësia e punimit

13

2.2 Jeta dhe vepra e Bilall Xhaferit

15

2.3 Profili poetik i Bilall Xhaferit

23

Kapitulli III

3.1 Analiza e veprave prozaike Krastakraus dhe vëllimi me tregime

30

Njerëz të rinj, Tokë e lashtë

3.2 Vepra Krastakraus

39

3.3 Analiza e personazheve

49

3.4 Ngjarja

54

3.5 Mesazhi

58

Kapitulli IV

4.1 Kritika letrare për veprën në poezi dhe prozë

62

4.2 Mjeti satirik – Sarkazma

67

4.3 Krahاسimi i dy veprave të Bilall Xhaferit

69

4.4 Vërtetimi i hipotezave

73

4.5 Përfundimi

74

Bibliografia

78

Literaturë

79

Linqe

80

Hyrje

Bilal Xhaferi është poet, prozator, publicist i shquar në letërsinë shqipe, edhe pse me pak vepra të botuara, ai emërohet si një ndër krijuesit më të dalluar të shekullit XX. Duke parë krijimtarinë e tij, ajo që më tërhoqi më së shumti në studimet e mia postdiplomike, është, vepra e tij “Krastakraus” që më bëri kureshtare për ta studiuar edhe më tepër në punimin shkencor. Veprat e tij “Krastakraus” dhe “Ra Berati”, tregojnë rrjedhën e kohës gjatë luftës, dhe tradhëtia që i vjen qytetit të Beratit, pikërisht nga njerëzit e tij. Nga ajo që mësova, kuptova se Bilal Xhaferi ishte një shkrimtar që ndiqeshte nga regjimi komunist i asaj kohe. Për fat të keq pena e tij do t’i humbej shumë shpejtë. Duke pasur parasysh jetën e tij që e pati me shumë sfida nga mosha 10 vjeçe, ai nuk arriti t’i nxjerrë në dritë të gjithë veprat nga censura komuniste. Ne mund të themi lirisht se edhe me kaq Bilali e pasuroi letërsinë shqipe, i dha një frymë ndryshe nga poetët tjerë, e bëri më të përsosur dhe arriti që veprat e tij të lexohen edhe sot e kësaj dite tek lexuesit e rinj, për ta kuptuar diktaturën që e kishte mbërthyer Shqipërinë atëherë.

Në veprat e Bilal Xhaferit gjen vend historia, ose mund të themi se veçanërisht romani “*Krastakraus*” është një histori, po është e rëndësishme të shihet se si një poet e sheh dhe e përshkruan një histori, një luftë, një trim. Subjekti i veprës është përshkrimi i historisë së një periudhe të caktuar kohore dhe e një hapsire të caktuar me të gjitha rrjedhat e ngjarjeve, që zhvillohen në atë kohë e në atë vend.

Përmbledhja e tregimeve “*Njerëz të rinj, tokë e lashtë*” sjell frymën popullore, gjetjen e zgjidhjeve reale historike për kontradiktat e konflikteve. Po ta pranojmë mendimin e njohur “stili është njeriu”, do të thoshim me gojën plot se një shembull i bukur për ta provuar atë është ky i dënuar i letërsisë që humb në jetë për të fituar në letërsi.

Ajo që më shtyu edhe më tepër të hulumtoj për këtë shkrimtarë është, për t’i shprehur të pathënat e tij, të tregoj se ishte një poet i drejtëpërdrejt, realist me lexuesin, i cili u detyrua të largohej nga vendlindja dhe të botojë veprat e tij, kushtuar atdheut. Vepra e tij nuk ka qenë e mundur të shkruhej aq sa ai meriton, edhe pse është folur vazhdimisht që kur është shfaqur në letërsi e deri më sot.

Proza e Bilal Xhaferit të bën të kuptosh botën e brendëshme të heshtur, me periudhën realiste dhe me jetën e vështirë të njerëzve, që u shfaqet vazhdimisht në rrugëtimin jetësor,

megjithëse jeta u varej nga puna si minatorë, njëkohësisht edhe si heronjë të vendit të tyre.

Ajo që e bën edhe më të spikatur Bilalin është revista “Krahu i Shqiponjës”, ku arriti ta themelojë në SHBA më vit 1974.

Pa mos e harruar Çamërinë matanë detit, meqenëse ishte origjina e tij, ai tregon se çamërit janë në atdheun e tyre, kanë lindur në Çamëri dhe për çamërit është vendlindja e tyre, ku thekson se është një vend i vjetër rreth 3000 vjet më parë, nuk është një vend i blerë, por i banuar nga ata, e deri sot në kohën tonë.

Për aq sa mësova, tema kryesore që e shtjellon poeti në krijimtarinë e tij, është, “Shqipëria e të gjithë shqiptarëve, etnike, demokratike, evropiane”. Shqipëria për poetin është një, e jo disa copa, sikurse ishte e ndarë politikisht.

Në këtë punim duke u bazuar në burime të shumta që flasin për Bilalin dhe veprat e tij, vijmë në përfundim se askush s’mund ta mohojë kontributin e tij për letërsinë shqipe, që e pasuroi në shekullin e kalua, me një frymë ndryshe nga të tjerët. Letërsisë shqipe i dha një peshë të madhe duke u bazuar në ndodhitë e asaj kohe dhe të epokës së Skënderbeut, pikërisht në periudhën e sundimit osman. Kjo epokë në romanin e tij për lexuesit ishte shumë e afërt sepse shkrimi i tij magjepës, i bënte ata ta ndjejnë betejën ashtu siç kishte ndodhur.

Për këtë vepër kaq madhështore e bëri që Bilali të shkojë nëpër vendet shqiptare për të mbledhur të dhëna reale nga ajo luftë e egër e cila solli shumë fatkeqsi në tokat shqiptare, për të cilën ai donte që të merte pjesë në mbledhjen e Lidhjes së shkrimtarëve që bëheshte në 500 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut.

Nuk dyshohet në rëndësinë e tij që pati në letërsinë shqipe në përgjithësi, e në veçanti të viteve 60-ta. Janë disa fakte që flasin për këtë. Por neve më parë se faktet historike në këtë punim do të na interesojë proza e rrëfimit të epokës së Skënderbeut dhe ajo e regjimit komunist, si dhe në vlerësimin që i bëhet Bilalit pas vdekjes së tij, domethënë pas rënies së regjimit.

Për këtë kanë shkruar edhe shumë shkrimtarë të tjerë, se ishte një talent i rrallë dhe që ndiqeshte vazhdimisht.

Struktura e këtij punimi përbëhet prej katër kapitujve, dy kapitujt e parë brenda vetes

përmbajnë nga tri tema, ndërsa dy kapitujt e fundit përmbajnë nga pesë tema.

Në kapitullin e parë të punimit do të shohim rrjedhën e punës metodologjike dhe format e saja duke u mbështetur në hipoteza dhe qëllime.

Në pjesën e dytë të kapitullit do të njoftohemi me rëndësinë e punimit që kemi parë në romanin “ Krastakraus “ dhe në vëllimin me tregime “ Njerëz të rinj, tokë e lashtë “. Më pas mbi jetën dhe sakrificat e tij që bëri në Shqipëri, mbi shkrimet dhe arratisjen në SHBA që iku nga ky vend por që nuk ndaloi së shkruari. Viojmë edhe tek profili poetik, Bilal Xhaferi si poet i shquar, zgjedha të analizojë disa poezi të tij, të cilat janë lexuar dhe analizuar edhe nga shumë shkrimtarë të tjerë, duke patur parasyshë jetën me bëmat e saj që pati, ai i thuri shumë bukur vargjet në poezi.

Në pjesën e tretë të punimit dhe më kryesorit, jam përpjekur të analizojë rrjedhshëm romanin e tij Krastakraus duke e vlerësuar historinë e asaj epoke të përgjakur që e njohim edhe si humbje, përfshirë edhe novelat dhe tregimet, duke i shqafur ashtu natyrshëm personazhët të cilët ishin shumë të thjeshtë, por që me madhësinë etyre si personalitete e zbukuruan prozën e tij dhe i dhanë një frymë ndryshe për ta njohur më thellësisht traditën dhe kulturën shqiptare.

Me ngjarjen kuptojmë një periudhë, e cila flet vite me rradhë që nga epoka e shekullit XIV e deri në kohën kur jetoi poeti.

Mesazhi flet dukshëm si në shkrimet e poetit ashtu edhe tek punimi ynë, për të mbajtur qëndresë, për të sfiduar jetën me shumë sakrificë dhe për ta shprehur mendimin ashtu siç na thotë zemra e jo regjimi.

Në pjesën e fundit konkretisht kapitulli i IV paraqet edhe një pjesë shumë të rëndësishme në punim, duke i parë të arsyeshme kritikën e shumë shkrimtarëve tjerë që janë marrë me Bilalin dhe shkrimet e tij.

Sarkazma që njihet në letërsi si tallje, por që poeti e konkretizon vetëm në disa tregime, por e mbështjellur me një realitet të hidhur shqiptarë.

Krahasuam dhe vlerësuam në mënyrë të veçantë dy veprat më të rëndësishme, duke përfshirë në këtë rast vëllimin me tregime dhe romanin Krastakraus, i cili me një stil krejt ndryshe depërton lehtë në thellësinë e lexuesit dhe me këtë arrinë cakun kulmor, si “ poet i shpirtërave njerëzor “.

Dhe në përfundim, do t'i përmendim disa karakteristika që e bënë të dallohet ky shkrimtarë nga shkrimtarët e tjerë, me një biografi ndryshe, historiku i jetës së tij flet hapur, se ishte i ndjekur, i plagosur, kritikues i Kadaresë dhe që nuk ndaloi së shkruari, meqenëse u arratis në SHBA ai përsëri shkruajti për Shqipërinë që e shihte me sytë e mendjes, ndërsa ne sot e shohim me sytë e ballit.

Kapitulli I

1.1 Qëllimet e punimit

Qëllimet e këtij hulumtimi janë:

1. Motivi i pare që më shtyu të zjedh këtë temë ishte se ky autor nuk është përmendur aq sa duhet, veprat e tij nuk janë prekur nga studiues të tjerë, kur dihet e kaluara e Bilal Xhaferit si person i padëshiruar nga sistemi i atëhershëm komunist. Proza e Bilal Xhaferit të meson të vërtetat historike dhe vuajtjet e shumta nëpër të cilat kaloi populli shqiptarë në luftrat me armiq të ndryshëm për vite me rradhë.
2. Është fakt se nëpërmjet një vepre të një shkrimtari të mirfilltë si është Bilal Xhaferi mund të mësojmë edhe shumë të dhëna për fatin e gjithë popullit tonë që përjetoi një të kaluar të hidhur nga regjimi totalitar komunist.
3. Rëndësi të veçantë proza e Bilal Xhaferit ka edhe për kohën kur është shkruajtur, në këtë periudh shqiptarët në përgjithësi kishin një ëndërr të përbashkët që aspiroheshin për një jetë të re pa brenga.
4. Përveç prozës ai iu përkushtua edhe veprimtarisë publicitike duke u marrë me përshkrime, reportazhe, artikuj e kujtime. Kjo nuk do të thotë se autori la anash poetikën. Ai do të merret me vjerësha të pandërprera, kushtuar popullsisë së çamëris dhe të vendlindjes së tij. Në poezi ai do ta shpreh revoltën e shoqëris, aksionin e etheve, shqetësimin e përhershëm dhe dhembjen që bartë më vete.
5. Në vëllimin “ *Lirishta e kuqe* “ poeti rrëfen, ngjarjet e dhimbëshme që u motivua nga sistemi komunist, por si do që të jetë ai do të përballon, duke shkruar poezi të ngjyrosura, të ndritshme, që do ti zgjasin shumë pak duke përfunduar me tragjedi, e prerë dhe e këputur në mes.

1.2 Hipoteza

Hipoteza 1: Si shumë shkrimtarë të tjerë edhe Bilal Xhaferi e nisi veprimtarinë letrare me vjersha, si poet, si prozator më vonë edhe si publicist. Veprimtarinë publicistike e vijoi me përshkrime, reportazhe, të cilat lane gjurmë të thella nëpër gazeta dhe revista të ndryshme për vlerësimin e drejtë të traditave letrare të Rilindjes Kombëtare.

Hipoteza 2: Te proza dhe poezia e tij nuk janë vetëm artistike, por ato shprehin situatën reale në të cilën gjendet populli, në kushte të vështira sociale dhe këtu vërehet mprehtësia politike në trajtimin e problemeve kontardiktore gjatë periudhës diktatoriale.

Hipoteza 3: Në veprat në prozë dhe poezi hapen shtigjet e veta në thellësi, nëpër veprat e Bilall Xhaferit ka vendosur pamje nga e kaluara, trashëgimi, këngë çame, nga vendlindja e tij. Bilali i ngjan vetëm një artisti punëtor, që krijimet e tij do të shkëlqejnë në një kohë të re.

Hipoteza 4: Kërkimi ynë shqyrtues për këtë temë ka të bëjë me qasjen e qarkut tematik në prozë duke arritur t'i përmbledhë shkrimet letrare, marrur parasysh edhe sfidat që do ti has gjatë krijimtarisë, arrinë të mbivlerësosh punën e tij me një punim shkencor.

1.3 Metodologjia

Faza e kërkimit

. Studimi mbi jetë e autorit, mbi veprën poetike dhe prozën letrare për të cilën e ka shprehur në gazetën “ Drita” “ Ylli ” “ Nëntori” dhe tek revista “ Krahuri i shqiptarëve” që e botonte nga SHBA-ja

Faza përgatitore

- studimi veprave në prozë “ *Krastakraus* ” , “ *Ra Berati* “ , “ *Malet vështrojnë drejtë qiejve* “ , “ *Trotuare të kundërt* “ , “ *Hëna e kantierëve* “ dhe libri me tregime “ *Njerez të rinj, Tokë e lashtë* “ si dhe përmbledhja me poezi “ *Lirishta e kuqe* ”.
- formulimi i platformës studimore të veprës “ *Krastakraus* ” si dhe poezisë “ *Lirishta e kuqe* ” nga Bilall Xhaferi. Duke i trajtuar këto shkrime hasim figura të ndritshme, fenomene letrare që kanë të bëjnë me të kaluarën e historisë së shqiptarëve, gjetjen e zgjidhjeve kombëtare, frymën popullore, thjeshtësinë dhe saktësinë.

Faza e mbledhjes së të dhënave

- studimi i literaturës: “ *Vepra letrare 1 Poezi*” Bashkim Kuçuku, “ *Vepra letrare 2 Tregime* “ , “ *Vepra letrare 3 Romane* “ , “ *Vepra letrare 4 Publicistikë* “ , “ *Vepra letrare 5 Kujtime* “ , “ *Poezi dhe identitete* “ Ahmet Selmani, “ *Figura të shquara të Çamërisë* “ Mirela Kondi, Antologjia e letërsisë bashkëkohore shqiptare “ *Maga e çelur* “ Gjergj Zheji – Natasha Xhafka, “ *Vjersha të Bilal Xhaferit* “ Namik Mane, “ *Leksikon i shkrimtarëve shqiptarë* “ Hasan Hasani.

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

- Bazohemi në materialet e disa studiuesve që janë marrë me shkrimet e Bilal Xhaferit, më të veçuar janë: Bashkim Kuçuku, Sabri Hamiti, Kujtim Shala, Namik Mane etj.

- pasqyron me realizëm kohën së cilës i përkushtohet, në mbarë hapsirën arbërore, por kryesisht luftën për jetë a vdekje kundër barbarisë turke. Kohës së luftës së

shqiptarëve, sa tragjike aq edhe dramatike. Rrëfen rrjedhën e ngjarjes së kaluar historike dhe u jep motiv për të qëndruar heroikisht përpara jetës . Tema kryesore për të cilën shkruan poeti është liria dhe demokracia mbi gjitha.

Metodologjia e kërkimit

- Në bazë të qëllimit të punimit, metodologjia e kërkimit mbështetet në veprat e Bilall Xhaferit, duke sqaruar më hollësisht ngjarjet nga jeta e tij dhe dukurit e ndryshme që i shfaqen mbrenda rrugimit si poet. Më pas edhe historin e epokës së Skënderbeut që na e paraqet në romanin ” Krastakraus” për të treguar një rrënie të dhimbshme që e prek popullin shqiptar dhe se nga anësh kishte dhe ndiqeshte nga një grup tradhëtarësh.
- Veprat prozaike analizohen secila në veçanti dhe arrihet përfundimi për të kuptuar se Bilal Xhaferi është njëri ndër krijuesit e shquar të letërsisë shqipe, krijimet e tij i shprehu si ngjarje që përmend në vepra dhe i thotë në mënyra të figurshme e jo të drejtëpërdrejta, kundërshtuese.

Kapitulli II

2.1 Rëndësia e punimit

Bilall Xhaferi është një autor me shumë vlera në letërsinë tonë. Veprat e tij në **prozë** edhe pse janë analizuar dhe komentuar shumë, gjithmonë kanë diçka të re për të diskutuar. Shumë studiues kanë folur mbi veprat e Bilall Xhaferit dhe vlerat e tyre.

E veçanta e këtij poeti është, përballja me rendin shoqëror dhe me censurën. Disa dorëshkrimet e tij kanë humbur dhe janë shkatërruar, mbeten vetëm disa të cilat arriti t'i botoi me vështirësi dhe të tjerat do të botohen pas vdekjes së tij.

Duke nisur nga vëllimi me poezi “ Lirishta e kuqe “, romanin “ Krastakraus “ me titull “ Ra Berati “ ai do të na rrëfej, dashurin ndaj atdheut dhe tradhëtia që i vjen nga njerzit e mëdhenj. Vepra “ Krastakraus ”, mbetet ndër veprat më të arritura të B. Xhaferit, me plot mjeshtri dhe ironi therrëse ndaj burokracisë rrënuese që ndërtoi sistemi komunist. Ndonëse vetë shkrimtari është shprehur se me veprën “ Krastakraus “ do të ndryshojë përfytyrimin e letërsisë shqipe, për një shumicë lexuesish kontributi më i rëndësishëm letrar i tij në prozë dhe poezi është revista “ Krah i Shqiponjës “ të cilën e botonte në SHBA.

Ndërsa për veprën “ Krastakraus “, Bilall Xhaferi edhe pse merr temën nga koha e komunizmit , vepra e tij trajton çështje dhe ide të tilla që kanë të bëjnë me jetën ekzistenciale në tërësi. Poezia dhe proza e tij shtron dhe analizon dashurinë dhe urrejtjen, fitoren dhe dështimin, egoizmin dhe idealet njerëzore.

Në këtë punim magjistrature do të analizohen të gjitha këto ndjesi të autorit, se çfarë ka dashur ai të thotë në veprat e tij qofshin në prozë apo në poezi, si është ndjerë në periudhën e komunizmit, ndryshimet e kohës, ngjarjet që kanë ndodhur në atë periudhë etj.

Vepra e tij “ Krastakraus “ , “ Ra Berati “ është përkthyer e botuar në Amerikë kur u largua nga Shqipëria. Edhe vepra “ Lirishta e kuqe “ mund të themi se është vlerësuar më shumë nga kritikët dhe është lexuar më shumë nga njerëzit e ndryshëm. Prandaj, mund të themi se Poezia dhe Proza e tij janë të një rëndësie të madhe.

Tregimet e Bilal Xhaferit janë shkruar dhe botuar në vitet 60-80 të shekullit të kaluar, për nga origjinaliteti i tyre ata janë të pasuruara në shumë aspekte, duke nisur me dukuritë natyrore të

cilat në prozën e Bilal Xhaferit kanë një rol të veçantë, dhe ai konkretizon natyrën e bukur barin e gjelbërt, era e ftohtë e lehtë, mjegullat e errëta, shiun e freskët.

Natyra si metaforë, dielli, perëndimi, muzgu, vjeshta, lumi, mjegulla, agimi, errësira, toka, etj., të përshkruara shpesh, duke u kthyer, herë pas here në leitmotive, theksojnë rolin qeniesor të tyre në jetën njerëzore. Personazhet janë në mirëkuptim, siç janë edhe në keqkuptim me to, vazhdimisht në skenën e paskajshme të natyrës, pranë saj si qenie dhe me botëkuptim.

Perveç këtyre ai me përkushtim të madh i përshkruan edhe personazhët të cilët i quan, besnik e puntorë, luftëtarë atdhedashës, muratorë dhe kavalerizëm, kavalerizmi, që jep përmasat e sjelljes tipike shqipëtare tradicionale, ku pa e njohur njëri-tjetrin shoqërohen dhe lënë punën për ti përcjellur dy vajzat në qytet përtej malit.

Sjellja, veshjet, gjestet, rrëfimet poeti i nxjerr në pah, duke treguar se ata nuk ishin të imponuara, por, vinin nga rrënjët e lashta të historisë së njerëzimit, që dalin në sipërfaqe në shënjë mirkuptimi me shoqërinë dhe me natyrën.

Prozën e Bilal Xhaferit që e bënë edhe më të veçantë janë përshkrimet e viseve apo trojeve shqipëtare duke i shtrirë në një horizont të gjërë, që e shihte nga Dukagjini deri ne Berat nga Janina e deri ne Durrës pa kufij, dhe e bashkuar si një tërësi.

Figurat legjendare që i japin peshë temës kryesore të prozës së tij janë heroi ynë Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Stres Piroli dhe Aleksandër Balsha, të cilët luftuan kundër një perandorie e cila sundoi me vite të tëra.

¹Me romanin “Krastakraus” dhe “Ra Berati” kuptuam se është një roman historik, që e përfshinë të njëjtën ngjarje por që e bën të dallon vetëm folja **Ra**. E vendosur në fillim, veprimi i rënies është befasi, e , me që nënkupton një rënie nga tradhëtia, pra, nga e papritura e pa menduara, ajo mund të krijojë edhe asosacionin e humnerës, që është një rënie e pakuptuar.

Rëndësi të veçantë, gjithashtu kanë edhe mesazhet që i përcjellin veprat në prozë dhe në poezi, që janë të vlerësuara shumë.

¹ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 3 Romane, Tiranë 2010, fq.13

2.2 Jeta dhe vepra e Bilall Xhaferit

Bilall Xhaferi - poet, prozator, dhe publicist.

²Bilal Xhaferi u lind në fshatin Ninat të Konispolit (Çamëri), më 2 nëntor 1936. Në vitin 1943, i vdes e ëma shumë e re, duke e lënë Bilalin veçse 8 vjeç. Ndërsa në fillim të vitit 1945, një fatkeqësi tjetër do të bjerë mbi familjen e tij. Babai i tij, Xhaferr Ferik Hoxha u arrestua pa gjyq si nacionalist antikomunist. Bilali mbiemrin e familjes e kishte Hoxha. Mirëpo thuhet se për mallin, dashurinë e nderimin për të atin, emrin e tij Xhaferri e bëri mbiemër të vetin. Pas pushkatimit të babait, fëmijët jetimë i mori gjyshi i cili ishte dhe i verbuar nga Lufta e klasave e filluar në mbarë vendin, la gjurmë të hidhura në shpirtin e jetimit 10 vjeçar.

Pasi mbaroi katër klasë fillore, në vitin 1948 për të siguruar jetesën dhe për t'u shpëtuar ndjekjeve si birr nacionalisti, largohet prej vendlindjes dhe fillimisht gjen punë për të ngarkuar dhe shkarkuar qymyr në anijet e vogla. Në vitin 1952 largohet nga Saranda dhe shkoi e u vendos në Durrës. Aty me motrën e tij, ndiqnin të dy shkollën shtatë vjeçare, motra ditën, ndërsa ai natën sepse ditën punonte. Që në këtë kohë zuri të shkruante vargjet e para, kreu një shkollë teknike për ndërtim dhe punësohet në kantiere ndërtimi, në Rruga-Ura në Krujë, në hidrocentralin e Ulzës. Bilal Xhaferi nuk arriti të ndiqte studimet e larta, pasi nuk ju dha e drejta e studimeve, për shkak të biografisë.

Fundi i vitit 1963 dhe 1967 ishte koha e shpërthimit të tij. Gjatë kësaj kohe botoi shumë tregime e poezi. Në vitin 1963, boton poezitë në gazetën “ Zëri i Rinisë “, “ Drita “, në revistat “ Nëntori “, “ Ylli “ etj. Më pas në vitin 1966 botoi vëllimin me tregime “ Njerëz të rinj, tokë e lashtë “, dhe fillon me romanin “ Krastakraus “, që është vazhdimi tregimit “ Purpuranti “, i cili njohu dritën e botimit në vitin 1993, vetëm pas vdekjes së tij.

Sulmet kundër tij ishin aq të menjëhershme, saqë e përjashtuan edhe nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, dhe humbi kështu të drejtën e botimit. Kjo i erdhi si pasojë e kritikës së ashpër, kundër romanit “ Dasma “, të Ismail Kadaresë. Duke qenë se jeta ju bë e padurueshme, sepse çdo ditë e kërcënonin, për tu arrestuar, ai detyrohet të largohet fshehurazi prej Shqipërisë. Vendoset në SHBA, dy vjet punon në gazetën “ Dielli “ të shqiptarëve të Amerikës. Në vitin 1971 dërgon për botim nga Bostoni, Shtëpisë Botuese “ Rilindja “ të

² Mirela Kondi, Figura të shquara të Çamërisë, Tiranë 2016, fq.230-231

Prishtinës, versionin e dytë të romanit “ Krastakraus “ me titull “ Ra Berati “.

Por si për të mos gjetur prehje as pas arratisjes nga vendlindja, një fat jo i mirë do ta përcjell edhe në Amerikë, edhe atje përndiqet nga Sigurimi i Shtetit dhe më 25 Nëntorë të vitit 1978, në Nju Jork plagoste me thikë, para se të shkonte në kremtimin e 100- vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Më 1981, ia djegin redaksinë e revistës “ Krah i Shqiptarëve “ bashkë me të gjithë dorëshkrimet dhe shkrimet që i ruante. Ndërron jetë më vit 1986 pas një operacioni, në Çikago të SHBA-së në rrethana të dyshimta. Më vit 1995, Qeveria Shqiptare vendosi kthimin e eshtrave të poetit në vendlindjen e tij, në qytetin e bukur të Sarandës.

Shkaku më i dukshëm i një vepre arti është krijuesi i saj, autori; prandaj dhe trajtimi sipas personalitetit dhe jetës së shkrimtarit ka qenë një nga metodat më të hershme e më të afirmuara të studimeve letrare. Për biografinë mund të flitet e të gjykohet për aq sa hedh dritë mbi vetë veprën e artistit; por natyrisht ne e mbrojmë dhe e përligjim biografinë edhe si një studim për gjenin dhe talentin, për zhvillimin e saj moral, intelektual dhe emocional dhe kjo ka interesin e vet të brendshëm; më në fund themi se biografia jep materiale për një studim sistematik të *psikologjisë* së shkrimtarit dhe të vetë procesit krijues.

Vepra e Bilall Xhaferit , emri i tij, si një prej shenjave referenciale të historisë së letërsisë shqipe është kërcëllitur nëpër dhembë, është mërmëritur e bërtitur, është vëzhguar e përplasur, pa pësuar atë humbje që shpresohet ”.

Krijimtaria e Bilall Xhaferit zë një vend të rëndësishëm në letërsinë e realizimit socialist. Ky autor është ndër më të shquarit që ka lëvruar lloje të ndryshme letrare, sidomos në fushën e poezisë dhe të prozës. Krijimtaria e shumanshme e Bilall Xhaferit , së bashku me krijimtarinë e autorëve të tjerë më të mirë, qëndron në radhët e para të letërsisë e të artit tonë të ri, ku gjejnë pasqyrim dhe shprehje të gjallë realiteti socialist, e sotmja dhe historia shqiptare, idetë e partishmërisë më të lartë proletare dhe karakteri kombëtar. Lirisht mund të themi se Bilal Xhaferi është një ndër figurat më të spikatura të letërsisë shqiptare, me një krijimtari të begatshme në llojin letrar, me shumë sakrificë ai do t’i përmbush llojet dhe gjinitë letrare, duke nisur si poet, prozator dhe publicist. Veprat e Bilalit janë padyshim të shkruara në mënyrë realiste, duke e ndjekur jetën e tij nga bëmat e shtetit, ai do t’i shkruaj me ndjenjë kombëtare, e që e shoqëron hija e zezë për të mos i shfaqur në liri nga një klasë e shoqërisë politike.

Për nga tipologjia, tregimet ndahen në tre grupe: me subjekt nga lufta Nacional-Çlirimtare,

tre tregime “ T’i je partizane “, “ U këput një yll “, “ Ëndërr e ndriçuar “.

Nga përditësia e kohës, tregimet “ Largim “, “ Në rrugë “, “ Dallëndyshja e furtunës “, “ Në mes të natës deri në agim “, “ Reportazh i vogël “, “ Era shtyn mjegullat e mbrëmjes” dhe “ Dashuri dhe fate “. Dy tregime janë përtej kohës “ Përtej largësive “ dhe “ Purpuranti “. Purpuranti për nga bukuria, mjeshtëria artistikedhe mjetet stilistike të përdorura është tregimi më i bukur i librit. Tema është fitorja e brendëshme morale, në disfatë dhe mbijetesa kur humbën të gjitha. Mesazhi: qëndresë, besim, se ditët e fitoreve do të vijnë.(Resmi Osmani) Me punën e vet të palodhur e me qëndrimin konsekuent ka dhënë ndihmesë të çmuar, për vlerësimin e drejt të traditave letrare të së kaluarës posaçërsiht të Rilindjes Kombëtare. Vepra e tij ishte një shpërthim ndaj skenave sepse ajo është realiste, sociale e angazhuar, me një shprehje artistike të drejtëpërdrejt. “ *Njerëz të Rinj, tokë e lashtë* “ më së miri e ilustron konstatimin e këtill, që dallohet për nga vërtetësia e përmbajtjes jetësore, fryma popullore, mprehtësia politike në trajtimin e problemeve, fizionomia kombëtare e tipave shoqërore, thjeshtësia dhe saktësia e paraqitjes së fakteve, subjekteve, gjuha e pasur dhe pa ngarkes të tepruar emocionale.³

Krijimtaria e Bilall Xhaferit , ashtu si gjithë letërsia jonë, shquhet për militantizmin e vet, për pasqyrimin e revolucionit tonë, të etapave të ndryshme të zhvillimit të tij. Veprat e këtij autori kanë pasur kurdoherë dhe kanë një prirje të dukshme drejt problemeve të mëdha dhe kyçe të historisë sonë kombëtare.

Po ta shohim me një këndvështrim krijimtarinë e Bilalit, kuptojmë se dedikon një tërësi reale historike nga e cila dënohej njeriu me vlera antikomuniste dhe e bën për të humbur jetën e vet, vetëm të fitoj arti letrarë. Me angazhimin e tij të palodhur, poeti shqaf interesim të madh për ta pasuruar edhe më shumë krijimtarinë poetike, të rrëfej për një epokë të ndjeshme që e përshkruan në kryeveprën e tij “ *Krastakraus* “ pa mos hezituat t’i shfaq vlerat historike kombëtare. Ai do ta sjellë mënyrën më të bukur të epokës së Skënderbeut, që e konsideron si një vlerë kryesore në dramën e historisë së popullit shqiptarë. Nga kjo lexuesi arrinë të kuptojë se Skënderbeu i takonte një periudhe shumë të hershme, por që me shkrimet e tij e prezanton si “ dell vital “ që rreh në të tashmen duke e prezentuar në mënyrë shumë të

³ Gjergj Zheji – Dr.Natasha Xhafa, *Maga e çelur*, Antologji e letërsisë bashkëkohore shqiptare, Tiranë 1995, fq. 381

natyrshme ngjarjet e asaj kohe.

Në veprat e tij “ Krastakraus ” dhe “ Ra Berati ”, me kurajo të admirueshme, Bilall Xhaferi i jep jetë kritikës sarkastike ndaj burokracisë dhe komunizmit .

Vepra letrare e Bilall Xhaferit krijoi traditën e re të letërsisë shqiptare. Ajo na bën të ndihemi me dinjitet përballë botës së madhe. Shkrimtar i madh i një “gjuhe të vogël”, ai është po aq i dashur prej lexuesve bashkëkombas, me ndonjë poetikë të re. “ Krastakraus “ është një vepër monumentale, njëherësh sa klasike dhe modern. E merr temën nga e kaluara historike e Shqipërisë e pikërisht nga periudha e luftimeve heroike të Gjergj Kastriot Skënderbeut, mbretit të shqiptarëve (1417-1467) i cili për një çerek shekulli përballoi me shpatën e vet dyndjet osmane në mbrojtje të shtetit shqiptarë. Imagjinata e fuqishme e këtij autori depërton nëpër mjegullën e mesjetës dhe përmes tablove dhe detajeve që përshkruan arrin t’i zbres nga trualli i legjendave heronjtë dhe t’i sjell ashtu të gjallë në sytë e lexuesve. Përmes jetës dhe bëmave të luftimeve shpaloset e tërë historia luftarake shqiptaro-turke, e fitoreve dhe e humbjeve, e tradhëtive dhe e qëndresës.

Në qendër të romanit ngruhet figura e Stresit, i cili ishte oficer i gardës së Skënderbeut dhe njëherësh ishte edhe i dashuri i ëndërrave të princesh Ajkunës, është fati që më shumë do të ndjek betejat luftarash se sa situata paqësore me dashuri. Fundi i këtij romani është një përshkrim mjeshtëror gati homerik, i një beteje tepër të përgjakshme, pa fitimtarë dhe pa të mundur.⁴ “ Krastakraus “ është njëherësh simbol i dashurisë dhe i qëndresës njerëzore, është simbol i fitores së qytetimit përball dyndjeve barbare të të gjitha kohërave.

Ndërsa “ Ra Berati “ përsëri flet për të njejtën kohë për historinë e Skënderbeut. Aty përshkruan momentin më dramatik të rënies së qytetit të Beratit, që ka qenë humbja më e madhe e shqiptarëve në ato 25 vite luftime të pandërprera. Esenca kryesore e kësaj pjese që e vë në dukje poeti është përsëri: qëndresa e popullit që e thekson se është karakteristika e veçantë jo vetëm e atyre viteve, por e tërë historisë mijëvjeçare të popullit tonë, ashtu siç është dashur të qëndrojmë e të luftojmë, ashtu i është dashur të qëndrojmë atëherë kur e ka humbur edhe luftën, të qëndrojmë në vendin e tij për të jetuar një herë i lirë

Si shumë shkrimtarë të tjerë, edhe Bilal Xhaferi e nisi veprimtarinë e tij letrare, me vjersha si poet. Me kohë fillon në mënyrë të qartë t’i hap shtigjet e veta në thellësinë e poezisë. Qysh si

⁴ www.sq.wikibooks.org

i vogël u mëkua me këngët çame, sepse origjina e tij vinte pikërisht nga fshati Ninat.⁵ Vjersha e parë e cila mban edhe emrin “ *Baladë çame* “, ku shihet qartë fryma e revoltës që në vargjet e para.../Ylberi si një përshëndetje e përbotur lamtumire /U zhduk matanë largësive...

Kjo poezi është shumë e dhimbëshme ku ndërfiten ethet që i japin aksion të brendshëm shqetësimi. Vëllimi poetik “ *Lirishta e kuqe* “ integron problemet qenësore të njeriut bashkëkohor shqiptarë. Rrëfimi i poetit ka gjithmonë diçka për të thënë: të shpalos imazhe të bukura, të tregon nostalgji për atë vend, dhe njëkohësiht përfytyron jetën e ashpër që e ndjek edhe jashtë atdheut të tij. Përveç poezisë “ *Baladë Çame* “ peshë të madhe përmbanë tek lexuesi shqiptarë edhe poezia “ *Kosovë* “ ku me një gjuhë të errët ai trajton botëkuptimet e hidhura të asaj epoke në Kosovë.

Për gjuhën që flet poeti në poezi paraqet me gjuhën e UDB-ës, kosovarët përveçse kishin gjuhën e nënës, ata flisnin kur kishte nevojë edhe gjuhën e UDB-ës. Nga ky kontekst poeti vjen i drejtëpërdrejtë kundër gjuhës sllave, i karakterizon vendet e gjuhës amë, dhe e zbukuron me atë begati që i bien këtij vendi.

Letërsia e Bilal Xhaferit përmban një galeri njerëzish e karaktere, për nga ana e prozës së gjërë ata dalin me disa vyrtite të ndryshme: kalorës, besnik, druvarë malësor, guximtarë që bëhen ushtarë, princër prijës me roje shërbyes, heronj si Skënderbeu, Hamza Kastrioti e Lek Dukagjini oficerë, priftërinj pranë ushtarëve dhe edukator të fëmijëve, tregëtar, princesha, kujdestare etj. Rëndësi të veçantë në krijimet e poetit ka edhe publicistika, e cila llogaritet si vëllim i katërt i poetit. Në publicistikë shtjellon vazhdimisht problemet jetike të kombit. Shqipëria e të gjithë shqiptarëve, etnike, demokratike, evropjane. Shqipëria, atdheu dhe kombi janë një e jo disa copa, e cila mbeti peng për poetin.

Ai me sytë e mendjes e shihte Shqipërinë dhe Kosovën, trojet etnike Maqedoninë dhe Malin e Zi, ku e shfaqte me sytë e ballit në letërsi të ndarë me shumë kufinjë.

Bilali ishte nga ata poet ku vazhdimishtë e ndiqte me vëmendje periudhën e rëndë politiko-shoqërore, dhe nga larg, ai për lexuesin krijoi revistën letrare “ *Krahu i Shqiponjës* “ më 1974, dhe për shumë kohë do të artikuloj për gjendjen politike të vendit, mirëpo fatkeqsisht, ato fotoreportazhe, njoftime artikuj, të cilat i krijoi poeti për të mos mashtrohen bashkatdhetarët, nuk do të arrijnë të lexohen në Shqipëri. Me shumë përpjekje publicistika e

⁵ Ahmet Selmani, Poezia dhe individualiteti, Shkup 1996, fq. 128

Bilalit do të merr përmasat e një kombi të trashëguar prej Rilindasve, natyrisht kjo do të ketë vështirësi, sakrificë batica e zbatica, për ta idealizuar në veprimtarinë e tij, me ç'rast ai do t'i integron problemet dhe ndarjen e Çamërisë, për t'i mbledhur shqiptarët që ishin të nadrë, për t'i bashkuar plotësisht në kushte demokracie. Këtë herë shkrimet e tij do të dalin më inkurajuese, për autoktoninë, historinë, traditën për Çamërinë e haruar, e ndaluar për tu shqiptuar në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Ku fatmirësisht kishte mbetur ende gjallë te atdhetarët e vet, tek vendi amë, por edhe në diasporë.

Vepra letrare e fundit që mban vëllimin numër pesë titullohet “ Kujtime “. Shumë rrjedhshëm aty shpaloset jeta e Bilalit në disa broshura të ndryshme, të shkruara nga miqtë e tij, duke i nxjerrë në dritë sakrificat e jetës së tij, idetë dhe vizionin për një Shqipëri të lirë dhe demokratike.

Proza e Bilal Xhaferit përmban një letërsi shumë prekëse dhe emocionale, aty prezanton jetën dhe fatet e njerëzve dhe të vetes së tij, konkretizon tregimet me një emër “ *Njerëz të rinj, tokë e lashtë* “. Në vitet e 60-ta proza e tij botohej në Shqipëri me qëllime të hapura publicistike. Kjo prozë e poetit shkonte në drejtim të poetve të tjerë, të ngjajshëm me prozat e Mitrush Kutelit, Ernest Koliqit, Vedat Kokonës.⁶

Titulli i kësaj vepre është me qëllim që të jetë e pranueshme në atë kohë komuniste, “ *Të rinjtë* “ sipas poetit është një emërtim ideologjik dhe i rëndomt apo i zakonshëm ku ai në mënyrë rutinore tregon vrytitet dhe dobësitë e njeriut të asaj kohe. “ Tokë e lashtë “ është e sakt burimore udhërrëfyese, shprehje metonimike, adekuate e prirjes së tij të brendëshme. Toka e lashtë është historia dhe përditshmëria, Iliria, Arbëria, Shqipëria, etniteti dhe identiteti kombëtar janë ilirët dhe shqiptarët.

Tregimet të cilat i shkruajti nga mërgimi ku interpretojnë jetën e vet ashtu siç ndodh në tregimet (*Purpuranti, Përtej largësive, Në rrugë, Në muygun e qetë, Helikopteri, Ave Maria, Vdekja në udhët e Çamërisë*) shfaq dukshëm jetën e dhunuar ose të tjetërsuar prej pushtetit totalitar që është herë drejtë progresit, e herë drejtë regresit, herë drejtë zhgënjimit, herë drejtë fatit, gjithmonë në kërkim të lumturisë për një jetë më të lirë.

Jeta e zyrtë e përpinde këta njerëz duke e shprehur tek tregimi “ *Në muzgun e qetë* “, se si i mbanin lidhur ushtarët që kishin luftuar për atdhe, ata i keqtrajonin si kafshë duke mos u

⁶ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 2, Tiranë 2010, fq. 8-10

kujdesur për jetën e tyre. Ndërsa në tregimin “ *Purpuranti* “ fjala vjen e poetit nga historia dhe lashtësia e vendit që e titullon edhe tregimin “ *Purpuranti* “ është xhaketa e zjarhtë që e mbanin njerëzit heronjë ashtu siç e mbante Stresi i cili luftoi për liri, i mbetur vetëm pa familje, pa shokë por që jetonte me krenari vetëm me fitoret e mëparshme, veshur me xhaketën e tij të purpurtë. Xhaketë të purpurtë që e simbolizonte heroin e vërtet.

Me romanin “ *Krastakraus* “ titull që të duket aq i panjohur, sa edhe i njohur, Bilali e ka titulluar nga krasta apo kreshta, vend që shfaq qëndres për të përballuar shkatërrimin nga tradhëtia, me rënien “ *Ra Berati* “ që e ndryshon vetëm kjo folje, ai do t’i motërzoj këta dy romane që nga larg e thekson humbjen nga fajet e shqiptarëve.

Te “ *Krastakraus* “ janë zhvilluar dukshëm disa përbërës të romanit historik, paraqitja e ngjarjeve dhe e bëmave sa më afër historisë, ku i portretizon personazhet kryesorë me tipare apo virtyte burrërore, luftëtar, mikpritës, atdhetarë, traditës. Ai do rrëfen për ngjarjen që kishte ndodhur 500 vjet më parë për njerëzit të cilët kishin jetuar 500 vjet më parë në mënyrë shumë të detyrueshëm ai do të mbështetet në faktet që i dëgjon nga legjendat nga tonponimet dhe nga kështjellat.

Tregimet e Bilalit janë thellësisht realiste, jashtë skemave të atyre viteve kur u shkruan dhe i takojnë zhanrit të tregimit modern. Kësaj gjinie të shkurtër, të vështirë por edhe me shumë mundësi për përkryerjen e mjeshtërisë dhe që i jep munësi më të madhe autorit, që të komunikoj dhe të përçojë idetë e tij të lexuesit. I nisur nga këto cilësi dhe mundësi të prozës së shkurtër, ai i sjell ndryshe nga tregimet tjera, ku mungojnë hyrjet, nisin direkt si një bisedë e lënë përgjys, ngjarjet rrjedhin natyrshëm, nuk ka kulminacione, mungojnë dialogjet, nuk ka konflikte të ashpra, zgjidhjet dhe përfundimi nuk janë të lumtur, por zhvillimi i idesë së brendëshme rrëfëhet.

Titujt e veprave

- ▯ “Njerëz të Rinj, tokë e lashtë “ viti i botimit 1966, Tiranë
- ▯ “ Lirishta e kuqe “ viti i botimit 1967, Tiranë
- ▯ “ Krastakraus “ viti i botimit 1993, Tiranë
- ▯ “ Ra Berati “ viti i botimit 1995, Prishtinë
- ▯ “ Trotuare të kundërta “ viti i botimit 1975, Çikago
- ▯ “ Hëna e kantierëve “ viti i botimit 1977, Çikago

2.3 Profili poetik i Bilall Xhaferit

Bilal Xhaferi përpos se u morrë me prozë, ai nuk la anash edhe krijimtarinë poetike, fillimisht ai shkruajti poezi të titulluar në vëllimin “ **Lirishta e kuqe** “Poezia e paktë e Bilal Xhaferit, edhe pse e ndrydhur nga skema e realizmit socialist, për sa kohë ishte në Shqipëri, ka një koncept, pikëvështrim, lëndë dhe përjetime të tjera, veçanërisht për atdheun. Ajo është e thyer, në tri faqe, në tri gjendje të ndryshme, njëra më e rëndë se tjetra. Me një koncept dhe pikëvështrim të tillë, ajo solli një nga përmbledhjet thuajse, munges në poezinë shqipe bashkëkohore të botuar në Shqipëri, shëmbëlltyrën, përjetimet e atdheut disident të mohuar dhe të anatemuar prej censurës.⁷

Poezitë e para i botoi në faqen letrare të “ Zëri i Rinisë ”, gazetën “ Drita “, revistat “ Ylli “ e “ Nëntori “ etj. Ai u shfaq si poet lirik emocional, spontan, disi ik, i frymëzuar plot freski e ndjenja të holla, me vargje tingëlluese plot bukuri. U pëlqye shumë nga lexuesit dhe rrethet letrare të atyre viteve. Poezia e tij ishte si një rrymë oksigjeni, jetëdhënëse që i drejtohej zemrës dhe ndjenjave më të mira njerëzore, që bënte kontrast me poezinë lavdëruese, të rreme e të shqerosur që shkruhej në ato vite, ku i përmblodhi në vëllimin “ Lirishta e kuqe “ që u botua në vitin 1967.

Poezitë që rrëfejnë, ndërtojnë situata lirike nëpërmjet të së cilave pretendohet jo një mbyllje e idesë ose e mesazhit, por një hapje. Derisa, poezia e përshkrimit idenë e fut në kuadrin e figurës ose zhvillohet si figurë e shtrirë në tërë tekstin, ku ideja bartet në rrafshin formal: pra, tekstit i mjafton të jetë figurë, ndërsa mesazhi kalon në emocionet autoriale, e nëpër këto emocione.

Në poezitë e përshkrimit idetë janë më të dallueshme, sigurishtë edhe shenjat autoriale, sepse idetë e thurura e të shpërfaqura në tekst jo vetmëm që e shenjojnë burimin e tyre, por edhe e tërheqin kah teksti. Në një kuptim më të gjërë, poezia e Xhaferit është poezi e emocioneve, në radhë të parë e tyre, dhe ideve, që, megjithatë, s’arrijnë ta determinojnë në poezi të idesë, ku përherë dallohet veta e lirikës.⁸

Sabri Hamiti si një studiues i poezive të tij thoshte Bilali ishte poet ndryshe nga brezi i poetëve bashkëkohës. Ai nuk shkroi mbi parimet e socrealizmit, për këtë dëshmon gjithë

⁷ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 1, Poezi, Tiranë 2010, fq. 28-30

⁸ Kujtim M Shala, Poezia e Bilal Xhaferit, Prishtinë, 2001, fq.15-16

poezia e tij.

Bilal Xhaferi është në radhë të parë, autor i poezisë “ *Lamtumirë Çamëri* “, duke qenë në SHBA, ai i nxorri në dritë vetë, poezitë e tij ku theksonte tragjizmin dhe dhimbjen e çamëve. Poezia “ *Lamtumirë Çamëri* “, e cila mund të konsiderohet si një vepër e veçantë, pavarësisht se është e përbërë vetëm nga disa vargje, brenda kësaj poezie, poeti tregon dhembjen e shqiptarëve që ndodheshin në Çamëri dhe që detyroheshin të largohen prej saj. Ishte një dhimbje e madhe që e prek edhe poetin, duke shprehur një tragjedi, ku shihet qartë se Çamëria është një nga faqet më të dhimbëshme të historisë shqiptare, sepse nga lufta shoviniste greke, arritën t’i vrasin dhe t’i shpërngulin një numër të madh shqiptarësh nga trojet e tyre etnike.⁹

Fati i shpërnguljes e ndoqi edhe poetin, i cili ishte i detyruar të largohej nga regjimi totalitar komunist. Me dhimbje të madhe shkruajti poezinë “*Lamtumirë Çamëri* “, kushtuar Çamërisë, ishte hapi i parë i poetit që e shpalosi brengën e tij nëpërmjet poezisë, duke e identifikuar ndjenjën e tij me natyrën, që sheh ylberin matanë largësive duke u zhdukur, dhe ashtu natyrshëm i dukej jeta e tij përtej skajeve të Çamërisë. Me këtë edhe e konstaton në vargun “ *Të gjithë rrugët të shpien në veri* “, e vetmja rrugë shpëtimtare që e shihte si strehim.

Përkundër saj, ai do ta përfytyroj kujtesën në vendin Çam, dhe do ti ngjallen edhe më shumë emocionet në vargjet në vazhdim, ku do të shpalos imazhet e trojeve të braktisura që i kullosnin rrufetë. Shpirtërisht ai do të mbetet i lidhur gjithnjë me Çamërinë, do ta ruaj pejzazhin e bukur të saj, kujtesën që ka kaluar në periudhën e fëmijërisë. Shpresa e tij nuk do të thotë se do të humbej pas këtij fati të zi, por , ai do ta ushqejë shpirtin duke i treguar se është krenarë me origjinën e tij.

¹⁰Në SHBA siç shkruan vet në revistën “ *Krahu i Shqiponjës* “ iu dogjën vëllime të tëra të pabotuara, shkrime politike, kërkime shkencore, përkthime, etj. Jeta e tij në një kaos censure nuk e lejoi t’i rishkruante ato. Në poezitë e Bilalit ndjehet dashuria, malli, patriotizmi dhe besnikëria ndaj atdheut.

Poezitë e Xhaferit herë-herë ndërtohen duke iu drejtuar lexuesit, duke marrë parasysh përherë. Pra, lexuesi nënkuptohet në tekst, brenda tij. Ashtu të drejtëpërdrejta nga motivi i atdheut, subjekti lirik i ikonës së shkrimtarit bashkë me të tashmen ai arrinë t’i rrëfen edhe në

⁹ Ahmet Selmani, Poezi dhe individualitete, Shkup, 1996, fq.22

¹⁰ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 1, Poezi, Tiranë 2010, fq. 23

krijimtarinë letrare. Poezia e tij pasurohej edhe më shumë kur poeti i vë në dukje figurat më cilësore të botës së jashtme. Një sërë simbolesh që vlen t'i përmendim janë: rrufetë, rretë, era, shiu, tufani, ylberi dhe të tjera, të cilat të ngjallin emocion të veçantë dhe e gjallëron poezinë nga ajo katrohurë që është veshur populli shqiptarë i asaj kohe. Janë këto simbole që sa do pak zbusin ndjenjën dhe shpirtin e lexuesit për të parë edhe më shumë rrjedhën e tyre nga koha komuniste. Natyra sipas tij është si dëshmitare për çdo vuajtje, prandaj, me shumë përkushtim thuajse në çdo poezi fut një simbol për ta përcjellur nga afër tragjizmin që depërton në popullin e tij.

Poezia e Xhaferit lidhet më një imagjinatë konkrete e pikëreferime motivore konkrete. Kjo poezi zë fill nga përditshmëria dhe thur përditshmërinë përgjat tekstit lirik. Poezia e tij motivohet nga emocionet dhe i eksplikon ato emocione në tekste letrare.¹¹

¹²Tek poezia “ *Baladë çame* “ sipas veçorive të llojit poetik, do ta quanim edhe vaje, nis me simbolin e *ylberit*, është befasues dhe i pazakonshëm për këtë lloj të lirikës, sepse janë lotët e ndarjes, të dashurisë dhe të përmallimit, me një fjalë, të vuajtjes psikologjike – emocionale. Shënohen të parët sepse shprehin hidhërimin më me forcë: */Ylberi si një përshëndetje /U ndez e u shua matanë largësive...*

Ky është vetëm hapi i parë i shpalosjes së kësaj skene të dhimbëshme, këtu ka diçka rrënjëthënëse që paraqet autori sidomos në vargun e parë ku dhimbja shpirtërore e poetit identifikohet me natyrën që e sheh, me natyrën që duket matanë largësive mbi krahët e flakëve nëpër shi. Ndërsa te vargu “ Toka çame “ rrëkon e mbytur me lot rrjedhin nga dhimbja fizike, dhe rrjedhin aq shumë sa janë bërë det duke u mbytur në tokë.

Për nga mënyra e ndërtimit të kësaj poezie del se Çamëria e humbur e ngelur mes plumbave që derdheshin në errësirë, njerëzit shikojnë rrugët që i shpien drejt në veri. Meqenëse ishte kjo një dyndje e madhe, poeti i jep motivin shpresë edhe pse jeta e tyre vishet në vise të ndryshme, Bilali spikat në krijimet e tij poetike ardhjen e pranverës në tokat çame të përshkuara nëpërmjet të një përfytyrimi poetik. Megjithëse ishte larg saj, ai jepte kujtesën e tij të freskët sikur i shihte aty për aty, ato livadhe të braktisura, dallëndyshet tek fluturojnë, dielli tek shfaqet. Natyrisht vetëm poeti me një shqetësim të fuqishëm mund ta bëjë këtë. E kjo arrihet të bëhet nëpërmjet dhimbjes dhe trishtimit, ku i merr përmasat e një pranvere të zymtë

¹¹ Kujtim M Shala, Poezia e Bilal Xhaferit, Prishtinë, 2001, fq.18

¹² Ahmet Selmani, Poezi dhe individualitete, Shkup, 1996

e pakëndshme bukurinë mahnitëse nuk ka kush ta shijon dhe çdo gjë është e pa nevojshme sepse mungojnë njerëzit e saj.

Krijimtaria e tij poetike është shumë voluminoze dhe është ndërtuar me ndjenjë të lirë që ne sot i themi poezi lirike ku shprehet malli për atdhe për heroin Skënderbe dhe për figurën letrare që ndriçon periudhën e Rilindasve siç është Naim Frashëri e shumë të tjerë. Mirëpo kjo nuk do të thotë se Bilali la anash edhe ata, siç e thekson në mënyrë subjektive aktin ç'njerëzor ndaj vendit të tij, fjala është tek poezia kushtuar Enverit, ku shpreh revoltën ndaj tij sepse e kishte kapluar nëna parti.

Bilali gjithnjë është treguar i ndjeshëm ndaj poezive të tij duke u përpjekur t'i realizon me dhimbje dhe dashuri për atdhe sa ka mundur, sepse motivi për ta cunguar këtë histori e rrëfen nëpërmjet ngjarjeve dhe përbuzjeve të ashpra që i vinin si pasojë nga vendi i tij...*Të huaj jemi këtu/ Të huaj jemi atje/ Kudo që vemi /Të huaj jemi.*

Shihet qartë thirrja e poetit tonë, ku trajton dhimbjen me shumë mall, shpreh vuajtjet që i trashëgon kudo ku të venë të huaj prap do të jenë. Sa do të përpiqen për të qenë të lumtur, largësia dhe malli për të do të mbizotron në shpirtrat e tyre.

Përsa i takon përmbajtjes, formës dhethurjes së vargjeve, Xhaferri është poet rebel. Ata që e kanë njohur(N.Mane etj) dëshmojnë se ai ishte poet spontan, mbante me vete një bllok dhe laps të vogël, poezitë i vinin vet-vetiu, për të ato ishin kënga e shpirtit dhe i lindnin nga gjendja e tij ideoemocionale dhe psikologjike. I hidhte në letër ashtu si i buronin nga gurra e tij krijuese, pastaj ai i lëmonte vargjet me kujdes si argjendari gurin e çmuar, deri sa ato të merrnin tërë shkëlqimin dhe bukurinë. Ndodhte që të njëjtën poezi, ta shkruante në dy-tri variante deri sa të arrinte te më e mira.

Për sa i takon poezisë së dashurisë ai e konkretizon thurje e tekstit mbi një kujtim, ky kujtim lidhet me një peizazhë. Peizazhi jepet nëpërmjet përshkrimit, edhe emocioni, andaj mund të rigjehen te njëri tjetri. Të tilla poezi janë: *Mjegulla, Ti lulëzon në peizazhet e trishta, Në inetrnim* e ndonjë tjetër. Janë poezi që duan ta krijojnë figurën e së dashurisë, kur ajo është larg, kur poeti është i mërguar dhe vitet i pakësohen pandalshëm.¹³

Si shumë poetë të atyre viteve, ai nuk zbaton kanunet e vjershërimit, rimat dhe metrikën, të cilat i konsideron si vargonj që lidhin mendimin pas formës dhe që kufizojnë shprehjen e idesë.

¹³ Kujtim M Shala, Poezia e Bilal Xhaferit, Prishtinë, 2001, fq.18-22

Vargjet e poezive janë të lira, të thurura pa rrokjet metrike. Ai shkruan se i do vargjet:/ *Krejt të lira/ Si hapësira,/ Si era,/ Si drita*

Te rubrika Letra revistës “ Krah i Shqiponjës “ bashkëpntori Shkëlzen Gjurmuleka ka shkruar: në poezinë “ *Natë çame* “ shpërthen një britëm e brendëshme plot mllef dhe egërrsi. Kjo britëm përfaqësohet nga ulurime e ujërve. Ajo si figurë nuk duhet kuptuar si personifikim i zërit të armikut por si një thirje e brendëshme e shpirtit të shqetësuar çam.¹⁴

E veçanta e Bilalit në krijimet e tij stinën e vjeshtës e qarkullon disa herë dhe e vë në dukje edhe në poezi, ashtu si e trajton rrjedhën e kohës ashtu ik vjeshta e lakuriqt, e dendur, humbet ngadalë ashtu siç u humb edhe Janina me lavdin e dikurshme dhe mbetet vetëm si një epokë e re.

“ Janinë vjeshtë “ poezia ku shpreh të njejtat rrethana dhe kanë motiv të përbashkët me poezinë “ Vjeshtë “, emocioni që shprehet është pikërisht për Janinën, mungesa e saj dhe vuajtja e cila do të ngërthej ndjenjën psiko-emocionale poeti për ta shfaqur në një horizont tjetër ku e gjente veten të lirë. Janinën e sheh me një pamje tjetër ashtu siç duket nga vendi grek edhe pse për poetin është vështirë ta përcepton, me shumë keqardhje cilëson Janinën e re të asfaltuar me vetura, hotele moderne, me emërtime greke.

¹⁵Bilali është poet lirik dhe emocional, në vargjet e tij ai derdh drithërimat e shpirtit dhe rrahjet e zemrës së shqetësuar, edhe kur në poezitë e tij jepen gjendje dramatike dhe dhembja e thellë e shpirtit,qofshin ato balada, elegji apo lirikat e dashurisë. Ato jepen plot ndjenjë, mendim e thellësi, për këtë i vjen në ndihmë stili i tij, fjala e gjetur,bukuria e saj dhe pesha që i jep mendimi.

Duke u nisur nga sistemi i vlerave dhe veçantive stilistike, poezitë më të bukura, me vlera antologjike, që do të mbeten si pjesë tërësore e poezisë shqipe janë: “ *Baladë Çame* “ , “ *Natë çame* “ , “ *Janinë vjeshtë* “ , “ *Kosova* “ , “ *Atdheu* “ , “ *Pranvera* “ , “ *T’i lulëzon në peizazhet e trishta* “ , “ *Eja trishtim* “ , e ndonjë tjetër. (Sabri Hamiti).

Në mbyllje të kësaj sprove e them me bindje se kjo është vetëm një zbulim i sipërfaqshëm. Krijimtaria e këtij poeti është si deti i thellë kus fshihen perlat. Duhet lexuar e rilexuar disa herë,

¹⁴ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 1, Poezi, Tiranë 2010, fq. 52

¹⁵ www.bulevardionline.com

në kohë të ndryshme, në mosha të ndryshme dhe në gjendje të ndryshme shpirtërore dhe ideo-emocionale. Pas çdo rileximi, jam i sigurt se do të zbulojmë plot të papritura që na kishin kaluar pa u vënë re...*Ndoshta do të më rrjedhë tërë jeta / larg asaj që e dua,/ larg asaj që më do mua.*

Stili i poezisë së Bilal Xhaferit

Duke e hetuar stilin e tekstit letrar të Bilal Xhaferit, shpërfaqen veçantitë gjuhësore e veçantitë e figurshmërisë së tij. Është e njohur thënia e Bufonit se, *stili është vetë njeriu*. Andaj, veçantia e poezisë së Xhaferit në kuptim të stilit, është veçanti e ndjenjave, e situatave personale të tij, të gjitha këto në lidhje me figurën. Stili i poezisë së poetit është artikulum i situatave (të rënda)të njeriut. Stili i poezisë së tij më së shumti është ligjërim i Njeriut që i del zot vetes Unë. Poezia e Xhaferit është lirike. Lirika në kuptimin e tekstit si një system, ndërtohen nëpërmjet lidhjes së motiveve.

Në përjasje me natyrën e krijimit stili i poezisë së Xhaferit është metonimik e metaforiko-metonimik. Kjo e lidhë tekstin me një konkretësi e me një fakticitet të jashtëm të stilit metaforiko-metonimik, janë ato pak tekste të dashurisë në të cilat kujtimet lidhen me peizazhin metaforik e me fatin e njeriut Bilal Xhaferi. Shihet se, këto dy tipe stili nuk lidhen drejtëpërdrejt me ndërtimin e ligjeratës gjuhësore por me figurën letrare. Ndërkaq në konkretësinë e vet dhe në lidhje me pozicionimin autorial, stili i poezisë së Xhaferit është: dramatik, elegjiak, balador, përkushtimor etj.

Në faqet e poezisë shohim një përjasje me figurën letrare, motivimin, e jo thjeshtë si ligjeratë gjuhësore. Andaj objekt esencial i këtij tipi del natyra e veçantë e njeriut dhe poetit Bilal Xhaferi.¹⁶

¹⁷Bilali është poet lirik dhe emocional. Duke e gjykuar në aspektin përmbajtësor tematik, tipologjia e poezive mund të përcaktohet në disa grupime: balada, elegji, poezitë e përkushtimit, të dashurisë dhe poemat. Përveç këtij përcaktimi tipologjik, poezitë e Xhaferit, mund ti grupojmë edhe në aspektin tematik, në atë se kujt i drejtohen dhe përse bëjnë fjalë.

Kësisoj gjuha e përdorur dhe qëndrimi ideoemocional ndaj objektit dhe subjektit, shprehin më së shumti botën e tij shpirtërore, idenë që kërkon të transmetojë te lexuesi. Këto ngjizen dhe

¹⁶ Kujtim M Shala, Poezia e Bilal Xhaferit, Prishtinë, 2001, fq.51-54

¹⁷ Resmi Osmani, Poeti i shpirtave njerëzorë (ese për veprën letrare të Bilal Xhaferit), Tiranë 2010

trupëzohen mjeshtërisht me figura e metafora që merren kryesisht nga natyra. Vini re vargjet e mëposhtme: */Pylli i vogël në lartësinë e kodrës mbi lumë/ Veshi gëzofin e mjegullave si shkumë,/ Dhe vuri në qafë shallin e mëndafshtë të Ylberit,/ Bie shi i argjendtë nëpër dritën e artë të diellit.*

¹⁸Xhaferri është poet tragjik. Studjuesi S.Hamiti e ka quajtur poet i “nemun”, ndërsa kritiku Kujtim Shala, e konsideron atë ndër poetët më tragjikë të letërsisë shqipe. Ngaqë: tragjike jeta e tij nga fëmijëria deri në vdekje, tragjik fati i Çamërisë dhe atdheut, tragjik fati i veprës së tij letrare që u ndalua dhe u burgos në dosjet e sigurimit të shtetit dhe që u gropos në tokë nga miqtë e tij për tu ruajtur e që për dekada mbeti e panjohur. Tragjikja që shprehet në poezitë dhe artin e tij, është shprehje e gjëmës dhe fatkeqësive personale, familjare dhe të bashkëkombësve, etnisë së tij. Tragjizmi dhe trishtimi që rrjedh sojesh janë shenjat e identitetit të tij poetik. Si njeri, si natyrë e ndjeshme, ai s’kishte si të mos e shprehte në art këtë gjendje të përhershme që e ndiqte ngado si një nëmë, si një mallkim.

¹⁸ Namik Mane “Dipolmacia e Botimit “ Miku i të gjithëve

Kapitulli III

3.1 Analiza e veprave prozaike: “ Krastakraus” dhe vëllimi me tregime “ Njerëz të rinj, tokë e lashtë ”

Një djalë i ri çam, teknik, gjeometër, duke punuar në kantieret e ndërtimit dhe “rrugaurës “ diku në zonën e veriut, do të orvatet të depërtojë dalëngadalë kontradiktat e “ socializmit “ e të mbajë gjithnjë e më të sigurt anën e pavarur në shumë lëmenjë të jetës sonë kulturore, letrare, mendore dhe shpirtërore. Në këtë kohë, megjithëse nuk pati ndonjë vepër aq të gjërë letrare Bilali u bashkërendit me letrarët në qiellin e letërsisë shqipe si një yll I madhësisë së klasës së pare. Krijimet e veta letrare e poetike i shprehu here me aludime e here ca më hapur, e me guxim, sidomos brengën e atdhetarëve të papërfillur prej atyre që kishin forcën në dorë, shprehu hallet e bujkut fshatar dhe ëndërrat e brezit të ri që aspironte një jetë të re.¹⁹

Në prozë bëri emër sidomos me veprat “ Krastakraus “ dhe “ Ra Berati “. Vlenë të theksojmë edhe librin me tregime “ Njerëz të rinj, tokë e lashtë “ ku përshkruan një sërë personazhe me ngjarje të vërteta të rënda nga realiteti i hidhur shqiptar.

Në këtë pjesë të punimit do të analizojmë romanet për të kuptuar se çfarë mendimesh ka pasur autori, si është ndjerë ai për ngjarjet e kohës. Kjo ngjarje e kohës është refleks i bindjes dhe jetës së autorit. Ngjarja e asaj kohe dhe i tërë romani është një metaforë e luftës së të mirës me të keqen, e jetës me vdekjen. Meqenëse me gjithë dhimbjen që ndjente ai u mundua të zbusë hidhërimin me dashuri, helmin e jetës me gëzim, mirëpo në fund lumturia as që duhej paramenduar, mbeti vetëm e ëndërruar.

Xhaferri, ka zgjedhur dy beteja të kësaj lufte: disfatën e Beratit dhe luftën e Oranikut. Të parën për të rrëfyer se humbja e një beteje, nuk është humbje e luftës dhe se me humbjen e një beteje, me rënien e një kalaje, nuk duhet humbur kalaja e besimit! Për të është i papranueshëm disfatizmi. Lufta e Oranikut, mbyll pjesën e parë të romanit. Xhaferri me mjeshtëri të habitshme dhe forcë të madhe krijuese arrin që në faqet e fundit të romanit të na

¹⁹ Hamit Xhaferi, Figura emblematike të shqiptarizmit, Tetovë, 2000, fq.246

japë atmosferën, gjëndjen shpirtërore të luftëtarëve para betejës, psikologjinë, ankthin e pritjes, padurimin për tu ndeshur. Beteja e Oranikut jepet si një ndeshje për jetë a vdekje.

Gjithashtu do të arrijmë në një përfundim se çfarë mendimi ka pasur autori për sistemin komunist e si mendon për rrëzimin e tij. Ky punim është një përpjekje modeste për të dëshmuar edhe një herë se brenda formësimit aktual dhe praktik të shenjave gjuhësore “fshihet” një botëkuptim i caktuar, i cili shpreh cilësitë shpirtërore të popullit që e flet dhe se gjuha është një realitet mendësor, kulturor, etnografik, historiko-shoqëror.

Personazhet e B. Xhaferit janë sa të çuditshëm aq dhe të zakonshëm, sa tragjikë aq edhe komikë, sa të thjeshtë aq edhe madhështorë. Nga pikëpamja janë të mbushura me personazhë tipik me pamje të skalitur, heronj e oficerë, njerëz të mëdhenj siç janë Lek Dukagjini, Hamza Kastriotin, Stres Piroli dhe Skënderbeu, të cilët kanë lëvruar një histori të bujshme të popullit shqiptarë. Dëshira për t’i përshkruar njerëzit e vendit të tij ishte e kahmotshme sepse kur punonte në kantieret e veriut, ai ëndërronte të bëhej poet, meqenëse personazhet i kishte të spikatur për nga natyra dhe karakteri.

Libri me tregime u botua në vitin 1966, ku përmbante brenda saj vetëm dhjetë tregime, “Njerëz të rinj, tokë e lashtë” ky nuk ishte titulli i sugjeruar nga autori, por duke i ditur rrethanat tejet të vështira biografike të tij, ai pranoi këtë titull skematik.

Sipas kritikut Sabri Hamiti, këtë vëllim tregimesh e quajti të dyfishtë, në pjesën e parë e shenjon ato tregime, karakteret e aktualitetit shqiptarë, madje shenjat personale të autorit në këtë realitet, duke e stërpikur këtë letërsi të aktualitetit edhe me ndonjë shenjë ideologjike të kohës.²⁰

Bilali me punën e palodhur e me qëndrimin konsekuent, ka dhënë ndihmesë të çmuar, për vlerësimin e drejtë të traditave letrare të së kaluarës, posaçërisht të Rilindjes Kombëtare. Vepra e tij ishte një shpërthim ndaj skenave sepse ajo është realiste sociale, e angazhuar me një shprehje artistike të drejtëpërdrejtë.

Shkruante për njerëzit gjëra të bukura, që të hynin e të mbeteshin në shpirt, bënte përshkrimet e natyrës i vishte me bukuri dhe hijeshi, me fjalë të rralla, të mbushura me frazologji dhe ndjesi të pastër.

Në fillim të veprës, kemi tregimin e parë të titulluar “Ti je partizane”, ku poeti spikat më

²⁰ Sabri Hamiti, Letërsia bashkëkohore, Vepra letrare 10, Prishtinë, 2002, fq.416

tepër gjininë femrore, nëpërmjet Safuas, ai tregon patriotizmin që kishte femra shqiptare në atë kohë. Edhe pse ishte vajzë e re e ritur jetime, mirëpo që e pjekur dhe shumë e matur, ajo iu nënshtrua vëllaut meqenëse ai ishte një ushtarë partizan, për ta mbrojtur tokën shqiptare. Vajza e cila kishte vendosur të bëhet partizane, vendosi të kaloj lumin që ndante ballistët dhe partizanët. Subjekti i këtij tregimi ishte i fokusuar tek Safua e cila ishte e fejuar me një ballist, mirëpo dashuria për vëllaun dhe vendin e bëri që ajo të kaloj lumin e turbulluar, të heq dorë nga i fejuari që ndodhej matanë brigjeve, janë tokat me pemë, në mes ndodhej ishulli. Është lumi i jetës që kërcënon t'i rrëmbejë heronjtë- vëlla e motër në vorbullën e tij. Kërcënimi u jep guxim ta kapërcejnë për të mbijetuar. Është edhe lumi i luftës së dytë botërore, që i ndau shqiptarët më dysh, në dy brigje, partizanë dhe ballist, prej nga qëllojnë njëri – tjetrin. Është edhe lumi i jetës së rrezikuar në vendlindje për shkak të luftës klasore. Dashuria ideale dhe e shenjtë tradicionale vëlla – motër, që tek shqiptarët mbërritur deri në ditët tona.²¹

“ Purpuranti “ është një tregim nga më të bukurit e prozës shqipe, zgjon shumë kujtime tek lexuesi shqiptarë për epokën Skënderbejane. Me një kompozicion dhe rrëfim klasik e të natyrshëm, autori mjeshtërisht jep një epokë të tërë, epilogun e saj dhe prologun e një epoke që po vjen. Ia vlen të ndalemi tek personazhi kryesorë i cili ishte njëri nga ata që kishte fituar besimin e Skënderbeut dhe që udhëhiqte një gardë me shumë ushtarë. Edhe fjala e përdorur *Purpurant*, e cila në metaforë e kthyer tregon elementin kryesorë të një ushtari të suksesshëm siç ishte Strezit.

Pas mbarimit të luftimeve, kthehet te Arqipeshkvi i Durrësit, Palë Ëngjëlli, t'i tregonte për rrjedhën e luftimeve dhe vdekjen e të vëllait meqenëse Arqipeshkvi mblidhte lëndë që të shkruante një libër për Skënderbeun. Kthimi i Strezit nga Durrësi për në veri është një rinjohje me natyrën e atdheut me intenzitetin më të madh emocional, duke bërë edhe llogarinë e luftimeve çerekshekullore. Strezit i rri barra e kujtimeve të tmerrshme të luftimeve, si dhe i shfaqet ëndërra e mundimi të kthimit të tij në jetë. Ajo që ka marrë si trofe, si shenjë të kësaj lufte të gjatë, është vetëm pelerina e purpurtë, që i shërben si shtrojë e si mbulojë në kontakt me natyrën. Në këtë valë të mundimshme të kthimit në vendlindje, ku duhet t'ia nis për së pari, pa trashëgimi e pa familje, rinjeh jetën në një këngë të moçme shqiptare të cilën e

²¹ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 3, Tregime, Tiranë, 2010, fq. 17-18

këndojnë njerëzit që e çelin malin për tokë buke. Strezi bëhet i vetëdijshëm përfundimisht nëpërmjet idesë dominante të autorit, se për të mbijetuar duhet të bëhet i ngjajshëm me malësorin i cili i bie fyellit, këndon këngën dhe hap shkëmbin për ekzistencë. Ai bëhet edhe vetë i ngjashëm me natyrën, me shkëmbin, me flokët si lëmyshkë, me trungun në rrënjën e të cilit mih. Në këtë vetëdije dhe njëjtësim me jetën reale të vendit e të kombit, luftëtari i moçëm, purpuranti e di që: “ ky komb i dashur e i shtrenjtë, që të ndriçonte një çerek shekulli në mes të errësirës, ishte djegur e përvëlur i tëri, kish shkrirë të gjitha energjitë e tij dhe, për t’i vënë në vend ato energji, kushedi sa kohë do t’i duhej akoma.”²²

Ky tregim ka një rëndësi të veçantë në veprën letrare të poetit, sepse është një prozë inicuese që jep shenjat e para dhe tonin themelorë të romanit “ Krastakraus “ për kohën e Skënderbeut.

Në tregimin “ Përtej largësive “, gjejmë shumë dukuri interesante e me vlerë për t’u vënë re, për t’u studiuar e peshuar stilin letrar që e solli në prozë, duke spikatur më tepër, vargjet, togëfjalshet, emra me mbiemra cilësorë si dhe frazologji me shprehje popullore dhe me dukuri natyrore.

Ashtu lirshëm e tregon ngjarjen në këtë pjesë, me ndjesi të hollë kur flet për dashurinë e Ergysit për Amardën. Këtu poeti flet edhe për periudhën e Skënderbeut që e tregon një histori të lashtë reale, e cila portretizon shqipatrët me shëmbëlltyrën që kishin për atdheun.

E quajti tregimin *Përtej largësive* duke kaluar përtej periudhës shekullore, dhe këtë largësi që u krijua edhe në vitet e 90-ta, ndoshta poeti e fut realitetin e tij përtej Oqeanit Atlantik dhe Oqeanit diktatorial, për të shkruar për Shqipërinë dhe bashkëkohësinë, dhe për t’ua rrëfyer atë që nuk mund t’ua thoshte nga afër.

Është lufta për liri që nga thellësia e shekujve, është lufta e qëndresës dhe çmimi që është paguar për të.

Ngjarja zhvillohet në kohën e kryengritjes ilire kundër pushtuesve romak. Heronjtë e këtij tregimi janë: Epiroti Ergysi, Algaldi Dardan dhe Amarda. Janë dy ushtarë të kryengritjes kundër romakëve që dashurojnë të njëjtën vajzë, Amardën. Të dy të dashuruar me të njëjtën vajzë, sa që janë të japin edhe jetën për të. mirëpo ajo dashuron vetëm njërin, e ai ishte Ergysi, i cili pa mos e njohur fare në shpellë ku ajo jetonte me të atin dhe dy vëllezërit,

²² Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 3, Kujtime, Tiranë, 2010, fq.178-179

erdhën pushtuesit romak për të bërë luftë kundër tyre. Ergysi edhe pse u mundua ti mbronte ata, nuk arriti që ti shpëtojë, i mbeti gjallë vetëm Amarda, të cilën e mori me vete për në kështjellën e Buklit. Kjo pra ishte historia e shkurtër por që i ngeli përjetësisht në mendjen e Amardës. Ishte edhe lumturia edhe fatkeqsia e saj, sepse e mundonte dilema Hamletiane “ të rrosh apo të mos rrosh “, sepse Algaldi erdhi për ta marrë e të martohej, meqenëse ishin të fejuar. Asaj ishin kthyer tanimë ndjenjat ndryshe, mendonte Ergysin dhe kështu vendosi që ta flijojë jetën e saj, duke iu thënë: “ *hyra midis jush si një sherr, u thotë ajo dhe do të mbetem midis jush si një kujtim, tani ju të dy do të jeni vëllezër, ua lë amanet. Merrni hakun e njerëzve të mi* “. ²³ Ajo vetflijohej duke u hedhur nga dritaret e kështjellës. Kjo qe lumturia tragjike e kohës. Kjo qe lumturia e kryengritjes, e njerëzve që vdisnin në emër të lirisë. Nuk mund të kishte lumturi vetjake kur atdheu rënkonte në rrobërinë e të huajve. Edhe pse humbën luftën ata ngushllohen se qëndruan deri në fund, e të qëndrosh deri në fund, është burrëri.

Autori e sheh këtë subjekt historik, si një urë lishëse midis së shkuarës dhe së ardhmes, e të përjetuarit të së djeshmes në të sotmen.

Në tregimet “ Në rrugë “, “ Dallëndyshja e furtunës “, “ U këput një yll “, “ Largimi “, thuajse kemi motivin e dashurisë, por që ka ngelur vetëm si një ndjenjë e trishtë. Sipas poetit tregimi “ Në rrugë “ ndodhitë apo ngjarjet ndodhin në rrugë. Siç ngjau me dy shoqe që ishin nisur për Reps, rrugës në atë kamion që udhëtonin bashkë me fshatarët ishte edhe një minator, i cili i shoqëroi dy vajzat dhe që ua rrëfen dramën e jetës së tij. Ai me një pamje të egërr dhe delikat, brenda shpirtit të tij fshihet ndjenja humane, i cili ka ditur ta kapërcej me dinjitet dramën e tradhtisë së të shoqes. Poeti ashtu delikat, përshkruan me ndjesi të madhe dashurinë e këtij minatori që kishte ndaj gruas, por jeta e vështirë e bëri që gruaja ti lakmohej luksit, ku e tradhëton burrin, ndërsa pasurinë e vetme që kishte- vajzën e saj, e harroi sepse shfrenimi i luksit ishte i tejkualuar.

Tregimi “ Dallëndyshja e furtunës “, edhe pse në pak faqe, ëshë një mrekulli artistike, që të ngulitet thellë në kujtesë dhe të ngjall në shpirt një ndjenjë lehtësimi e ngazëllimi. Rrëfimi është në vetë të parë. Në një guvë dheu hynë për të mbrojtur nga shiu dy minatorët. Aty, si në

²³ Resmi Osmani, Bilal Xhaferi poeti i shpirtërave njerëzorë, Tiranë, 2010, fq.50

një bisedë të lënë përgjysëm, minatori rrëfen shokut për fatin e martesës së tij, se si vajza guximtare e vetme, si një dallëndyshe në furtunë, pas ndalesës nga prindërit, udhëtoi 12 orë dhe shkoi te shorti që kishte zgjedhur vetë.

Në tregimin “ Largimi “ fundi i të cilit përfundon me largim. Në fillim përshkruhet virtyti i mirë i një vajze mjeke, që tërhek vëmendjen e një puntori, por që në fund reflekton ndryshe nga hera e parë. Duke i zgjedhur për moshën që kishin njerëzit, sjellja e saj e vrazhdë, bëri që t’i ikte një minator i ri i cili kishte ndjenjën e bukur të dashurisë për të, por që në fund zgjedh largimin, duke u dëshpëruar me karakterin e saj.

Ai filloi me njerëzit punëtor dhe i shfaqti edhe në tregime si personazh kryesorë nga të gjithë krahinat e vendit. Edhe pse ishin të thjeshtë, malësor por edhe klerik, oficer, ushtarë heronj e princër, poetit i mjaftoi ta paraqes shoqërinë shqiptare të asaj kohe me shtresime shoqërore morale. Duke patur parasyshë jetën e tyre në miniera e kantiere që punonin i shfaqti me një karakter të butë, të durueshëm para çdo lloj situatë. Jeta e tyre e vënë në tabanin komunist ndryshe nga demokracia, vihej në letërsi si personazh brilant të zgjuar, atdhedashës, mirëpo që u hiqej e drejta të avansoheshin për një jetë më të mirë.

“ U këput një yll “ trajton vetëtimshëm nëpër pistën qiellore. Humbet...zbehet...harroet...në sytë e njerëzve po. Kështu edhe Bilali në sytë e bashkëkohasve u harrua. Mirëpo një yll që këputet nuk është e thënë të zbehet, ndodh që thjeshtë i shmanget orbitës së vjetër, për të ndriçuar një tjetër orbitë. Dhe njerëzit kujtojnë se u shua e harrojnë...²⁴

Motivi i shprehur në këtë pjesë, e kuptojmë se është atdhedashuria, sepse ushtari i shtrirë për vdekje, në duart e shokëve të tij, lëngonte nga plagët e marura dhe kërkonte vdekjen. Por ajo që e ngjall këtë shpirt duke i harruar plagët e egra, ai ngrihet në këmbë befas, kur dëgjon krismat e mitralozëve që i vinin vendit të tij. Dhe ashtu me plagë i rezistoi luftës vetëm për t’i sjell vendit liri.

Në “ Tregimin dashuri dhe fate “, poeti trajton temë më të prekur nga tregimet tjera, vajza e cila e ndjek fati i keq në dashuri për moskuptime, kjo dashuri mbetet vetëm një ndjenjë që nuk harroet, e perealizuar që lë plagë në kujtime. Ngjarja nis me këtë subjekt sikur të kishte përfunduar, fytyra e Ildizes tregonte edhe fundin e dashurisë që kishte ajo, meqenlse ushtari i

²⁴ www.krahuishqipnjës.blogspot.com

ri ngatroi ndjenjën e dashurisë me ndjenjën e atdheut, e bëri që kjo lodhje të mbetet si kujtim në jetët e tyre. Shpesh e tillë është jeta ndryshe nga si e duam ne. Bilali nuk është shkrimtari i fundeve të lumtura, ngaqë vet jeta e tij ishte fatkeqe dhe tragjike.

Në tregimin “ Frikacakja “, kemi temë ndryshe nga ata me motive dashurie, edhe pse bëhet fjalë për Zhaven, një vajzë e cila ishte e veshur me të bardha, dhe ndodhej para një celebrimi që duheshte të thoshte po.

E quajtur frikacake nga poeti, sepse i tillë fati i femrës shqiptare aso kohe ishte tepër i vështirë, me shumë sfida dhe, për këtë ajo para njerëzve në celebrim frikësohej të thoshte – po.

“ Era shtyn mjegullat “, në këtë tregim autori është afruar dhe ka mbështetur kokën tek dritarja, ku përplasen kokrrat e breshërit. Një rufe shkrepëtinë me krisëm shurdhonyjëse, fare afër dritares. Kjo krismë rufeje në mendjen e Arturit shoqërohet me shpërthimin e minave në vijimin e kufirit ku u vranë shokët e tij. Ai vë dorën tek zemra dhe sytë i janë zgurdulluar, fytyra i është zbehur në ngjyrën e dheut.²⁵

Dhurata ishte një vajzë e ardhur nga qyteti që i studionte fshatrat për rreth, ajo nuk dinte se në çfarë rrethana punonin dhe jetonin fshatarët e mjerë. Papritmas asaj do t’i shqafet një skenë që do të godet në zemrën e saj, punën e minatorëve që përballeshin me minat dhe ku iu rrezikohej jeta e tyre. Frika atë e mbuloi, kur pa ato damarë dheu që kishin gropuar minatorët, për t’i vënë dinamitët nga të gjitha anët e pyllit, donte t’ia mbathte, por në moment dëgjohej zëri i fuqishëm i punëtorit minatorë “ Mina “. Dhe kështu poeti i cungon lidhjet e tyre dhe i vë në dukje ndjenjën e dhuratës që e ndjeu për Ismailin, sepse aty ashtu natyrshëm lind edhe ndjenja e dashurisë duke ia shpëtuar jetën asaj, i hedhur në trupin e saj për ta mbrojtur nga shkëmbinjtë e coptuar që plaseshin nga dinamitët.

Duke e ditur se poeti vjen nga Çamëria, tek tregimi “ Vajza nga brigjet e lumit Kalma “, ai shpreh dhimbjen për realitetin e hidhur të asaj kohe, kuptohet shpërngulja masovike që iu bë popullit shqiptarë. Ai nëpërmjet këtij tregimi shpreh dashurinë ndaj popullit dhe vendlindjes së tij.

Vajza të cilën e titullon tregimin, përmban një karakter human, të butë, e sjellshme dhe

²⁵ www.bg-bg.com

puntore, pikërisht vjen nga Çamëria dhe punon në Tiranë. Ajo mbante mend rrëfimet e gjyshes që ia kishte treguar se si ishte Çamëria. Këtë rrëfim ia shprehu një djaloshi të ri, i cili po edhe ai vinte nga ai vend i bekuar që u takuan në spitalin e Tiranës. Me shumë ëndje dhe ngazëllim, djali kujton fjalët e infermieres që ia kishte rrëfyer gjyshja çame.

“ Drejtim tej udhëkryqit “ përmabn një tematikë të dhimbshme dhe të ndjeshme, kur kuptojmë se bisedohet për mësuesin shqiptarë, rrënjqethet mishi dhe zemra të rreh fort, kur përfytyron situatat e këtij tregimi dhe veçanërisht kur shohim mësuesin e ngratë.

Ai kurrë s’kishte ndjerë liri edhe pse nxënësve u kishte folur për lirinë dhe për Skënderbeun e Ismail Qemalin. Me shumë sakrificë, ai donte t’ua mbjellte nxënësve krenarinë kombëtare dhe lirinë, edhe pse vet nuk e ndjeu si çështje por vetëm si nocion. Ishin nxënësit që e çmuan këtë figurë që kishin, dhe me shumë sakrificë nxorrën nga ai bodrum i lagësht që rrinte me ditë të tëra nga partizanët.

“ Në muzgun e qetë “ si personazhë kryesorë e shohim Azemin dhe Mehmetin, dy të rinjtë të cilët ktheheshin nga shkolla dhe tregonin për tmerrin e kohës që e kishin parë me sy. Se si të burgosurit i keqtrajtonin me një furgon ku i transferonin për një vend tjetër dhe aty rroja u rrinte me pushkë në dorë.

“ Helikopteri “ një tregim i cili poeti shfaq jetën a asaj kohe diktatoriale. Ziberin një njeri punëtor i cili kontribuonte në atë fermë vite me rradhë, kërkoi leje për funeralin e tezes, ai si një puntorë i vendit me shumë sakrificë e mund që punonte, nuk i lejohej e drejta për të shkuar në atë funeral, ngaqë drejtuesit e kësaj ferme nuk e llogaritnin si anëtar familje tezen.

“ Kujtimet për Çamërinë “ nuk kanë për tu humbur ashtu poeti reflekton në vëllimin e tij me tregime “ Njerëz të rinj, tokë e lashtë “, duke e futur tregimin “ Vdekja në udhët e Çamërisë “, që ia kujton poetit vendlindjen. Ai me shumë dashuri spikat përsëri heroizmin e femrës shqiptare, e cila jetoi e veproi fillkat vetëm, vetëm me një fëmijë, për ta ruajtur nderin e shtëpisë, ngaqë burri i kishte ikur për në luftë dhe nuk dihej se kur kthehej. Është një karakter i fortë i femrës shqiptare, me shumë mund arriti edhe ta krenojë burrin e saj me gjestin që ajo kishte bërë.

“ Reportazhi i vogël “ është një skicë me përsiatje filozofike për punën dhe lumturinë. Autori – gazetar kthehet pas 10 vitesh në kantierin ku ai kishte punuar, për të shkruar një reportazhë, por “ e mbytin “ kujtimet dhe emocionet. I shfaqen imazhet e tablove të punës së

stërmundimshme, ditën dhe natën, në shi e në borë, në urat mbi lumenjë dhe në grykat e qafat e maleve. Kështu shkrimtari shpërthen dhe zbrazë mërzinë e zjarminë e tij të brendshme, fare sheshit dhe ja seç thotë: “ *Ç’është heroizmi dhe ç’është lavdia...në jug dhe në veri, kudo ku janë hapur rrugë të reja, ato janë vaditur me djersën tonë, ato janë si të thuash, firmat që kemi hedhur ne në fletën e madhe të historisë...* ” Siç e ka vënë e Bashkim Kuçuku, rruga në krijimtarinë tregimtare të Bilal Xhaferit është simbol, metaforë dhe lajtmotiv. Motivi i rrugës është i pranishëm në shumë tregime, udhëkryqet janë piktakime, por edhe ndarje të fateve historike të vendit dhe popullit, por edhe të jetës dhe fatit të individëve.²⁶

²⁶ Resmi Osmani, Bilal Xhaferi, Poeti i shpirtërave njerëzorë, Tiranë, 2010, fq. 47-48

3.2 Vepra “ Krastakraus ”

Romani “ Krastakraus “ është historik e marrur nga epoka e Skënderbeut ku pasqyron me realizëm kohën së cilës i përkushtohet të gjithë horizontit arbërorë, kryesisht luftën shumëvjeçare nga perandoria osmane. Pikërisht poeti zgjodhi këtë epopejë të trishtuar sa tragjike aq edhe dramatike që e mban mend historia e popullit shqiptarë me humbjen e mijëra njerëzve të asaj disfate. E quajti një nga humbjet më të mëdha, më të përgjakshme të epokës së Skënderbeut sepse realisht humbi vetëbesimi i popullit për fitoret e radhës. Këtë betejë fatkeqe ku e vë në dukje në muret e Kalasë së qytetit të Beratit dhe që kalon deri tek zallishtet e Osumit, ku u vranë mijëra shqiptarë dhe disa napolitan. Ishte pika më strategjike që binte herë në duart e muzakëve dhe aranitëve, herë në duart e turqëve e herë në duart e Skënderbeut. Krastakraus ishte një fshat i vogël nën kreshtën e lartë të Tumenishtit. Fisi i krastakrausve tani qe strukturë nën sqetullën e këtij gjoksi, po dikur, siç thoshin pleqtë kish qenë një fis i madh. Rrënjët e tij fillonin te arbërit e vjetër dhe, më thellë, te albanët ilirë. Ata thoshin se edhe qyteti i Krujës nga ky fshat kishte lindur.²⁷

²⁸Hysa shkruan se romani “Krastakraus” është një vepër monumentale, njëherësh sa klasike dhe moderne. E merr temën nga e kaluara historike e Shqipërisë e pikërisht nga periudha e luftërave heroike të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, mbretit të shqiptarëve (1417-1467), i cili për një çerek shekulli përballoi me shpatën e vet dyndjet osmane në mbrojtje të shtetit shqiptar dhe të krishterimit. Është një vepër e shkruar mjeshtërisht. Imagjinata e fuqishme e këtij autori depërton nëpër mjegullën e mesjetës dhe përmes tablove dhe detajeve që përshkruan arrin t’i zbresë nga trualli i legjendave heronjtë dhe t’i sjellë ashtu të gjallë në sytë e lexuesve. Përmes jetës dhe bëmave të luftëtarëve të thjeshtë të Gjergj Kastriotit, shpaloset e tërë historia e luftërava shqiptaro – turke, e fitoreve dhe e humbjeve, e tradhtive dhe e qëndresës.

Romani nis në një qafë mali të Çorogjafit në Berat dhe, mbyllet me betejën e Oranikut. Në këtë hapësirë lëvizin, jetojnë e vdesin, meditojnë, dashurojnë, luftojnë, fitojnë apo humbin heronjtë e romanit. Është koha heroike. Për çdo stinë nga një luftë: vjen dimri,

²⁷ Sabri Hamiti, Vepra letrare 10, Letërsia bashkëkohore, Prishtinë, 2002, fq.381

²⁸ www.gazetadita.al

ikin turqit, ikën dimri vijnë turqit, dhe kështu valë-valë, vit pas viti.

Në kreun e parë lufta në fillim vjen si një jehonë, ajo ndjehet, atmosfera është e mbarsur me të. Pritet marja e kalasë së Beratit, Brenda së cilës kishin mbetur të rrethuar turqit.

Ushtria e Muzak Topisë e zënë në befasi, nga rrethuese kthehet në e rrethuar. Bëhet plojë e madhe, pastaj lufta bëhet e pranishme me gjithë egërsinë e saj në zallishtet e Osumit, ku pirgjet e kufomave dhe të varrët turq e shqiptarë, kanë mbushur gjithë anën e lumit.²⁹

³⁰Hapsira e luftës e shtrirë sipas shenjave gjeografike është e shtrirë prej Beratit në Krujë, Lezhë, Dukagjin dhe Oranik, përkatësisht në mjedise të tri dyerve princërore dhe fuqive ushtarake; Topijasve, Kastriotëve dhe Dukagjiasve e zgjeruar me anë të kujtimeve të personazhve gjer në Artë, në kufirin jugor të etnisë , të cilat përmbliidhen në disa vatra të ngushta veprime publike e familjare; Kulla e Albashaj në rrugën Berat-Janinë, e kthyer në han ku strehoen njësi rojesh ushtarake, kështjella e Lezhës, vendtakimi i Skënderbeut me Lek Dukagjinin dhe në Oranik fushëbeteja përmbyllëse. Pikërisht në kohën e Skënderbeut tregon se në këtë kullë vinin ushtarë nga Dukagjini e vise tjera, pushonin dhe mbikqyrnin rrugët e Krahinës. Ishin të ndërtuara dhe sendërtuara disa herë, meqenëse ishte e ndërtuar me gurë të kuq, por që ia vunë flakën për t'ia djegur çatinë dhe portat prej druri. E meremetuan njerëz të këtij vendi që ishin më të vjetër dhe përsëri e ngritën këtë kullë, që shërbente për strehim të ushtarëve. Ishte edhe vet Skënderbeu bashkë me Stres Pirolin të cilët u ndalën për të drekuar në atë kullë. Tradita shqiptare nuk harron kurrë mikpritjen dhe bujarinë që e ka të trashëguar brez pas brezi, edhe pse ishin në një gjndje të rëndë lufte, ato nuk nguruan të bënin bukën e ngrohtë prej misri dhe pulat e fshatit ku piqeshin aty brenda për t'iu servuar oficerëve dhe ushtarëve. Vepra nisi në qendër të Beratit sepse turqit kishin vendosur ta rrethojnë këtë qytet shumë të vjetër dhe të bukur me kalaja. Por, qyteti shumë shpejt do ta humb bukurinë e tij, duke i përshkruar poeti pamjet e dhimbëshme me kufoma dhe gjakderdhjet që kishin mbuluar vendin, plagosje dhe rënkime, kërkime për njëri tjetrin ashtu siç kërkonte zonja Mamicë burrin e saj t'i kthehej i gjallë nga lufta. E gjithë kjo vjen si pasojë e luftës së egër që vinte nga tuqit, por disa herë edhe nga italianët, të cilët shtireshin se ju vinin në ndihmë, e në anën tjetër

²⁹ Resmi Osmani, B.Xhaferi poeti i shpirtërave njerëzorë, Tiranë, 2010, fq.13,14

³⁰ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 3, Romane, Tiranë, 2010, fq. 10

kishin plane okupimi.

Ana tjetër që e njollos këtë histori është tradhëtia që i vjen nga Moisi Golemi, i cili kaloi në anën e turqëve dhe hapi rrugën edhe tradhtarëve tjerë që vinin pas. Lek Dukagjini i njohur si Princ i atij vendi, do të tërhiqet nga lufta me qëllim të shpëtoj interesat e principatës së vet. Kryetrimi zgjodhi qëndresën dhe luftën, edhe pse pati shumë humbje, ai e shumëfishoi ndjenjën e tij për t'i dalë zot vendit, qoftë edhe në rreziqe tjera të rradhës. Ai këtë qëndresë do ta përcjellë edhe tek brezat e rinj, sa do të humbur të jemi “do të shembemi e do të mbulohemi nën muret e kështjellave tona, por nuk do të bëhemi kurrë skllevër të lumtur “. Rrënohet Kalaja e Beratit, humbet, por nuk humbet kalaja e besimit.³¹

Subjekti i veprës

Romani “ Krastakraus “ ka një rrëfim të plotë, një gjuhë poetike dhe një ndërtim dramatik. Në të rindërtohet shoqëria shqiptare e kohës së Gjergj Kastriotit me shtresimet e veta shoqërore, psikologjike e morale. Aty janë gjeneralët, princat, princeshat, luftëtarët dhe një shtresë e popullit apo e qytetarëve.

Abati- Gjergj Pelini është njëri ndër personazhët ku që në fillim të veprës jep një mesazh të fortë: “ *ata që nuk mbahen, bien. Ky është ligji i parë i jetës e i luftës. Qëndresë deri në fund, të luftohet për jetën, po që e thënë të vdiset, le të biem si burra në fushën e nderit* “. Pas një humbje të madhe disfate, ai kur sheh Stres Pirolin shpreh edhe qëndresën duke patur besim se kjo ushtri shqiptare do ta mposhtë atë ushtri e cila në mënyrë barbare sulet nëpër gjitha viset e trojet shqiptare.

Molos Baderi ishte si tashëgimtarë i ushtrisë së vjetër Gjini Beu Shpatës theksonte se: askush nuk e ka trashëgim të fitojë nga herë. Në luftë edhe humbet. Duhet pasur besim te vetja, u humb Kalaja e Beratit tani të mabhet kalaja e besimit.³²

Çdo brez bën betejën e tij dhe i paguan luftës haraçin e gjakut. Luftën askush nuk e don por njeriu prap Lufton. I gjithë vendi në luftë ishte e njerëzit po hamendeshin ka t'ia mbathin, ndërsa Stres Piroli po gjurmonte gjurmët e Marashit, donte që kufomën e tij ta

³¹ Resmi Osmani, B. Xhaferri, Poeti i shpirtit njerëzorë (ese për veprën letrare të Bilal Xhaferit), Tiranë 2010

³² Resmi Osmani, B. Xhaferri, Poeti i shpirtit njerëzorë, Tiranë, 2010, fq.19

sjell në vendin ku ka lindur, edhe në qoftë se vdes, ai e quan si një akt burrëror sepse i reziston luftës së ashpër dhe sjell kufomën në shtëpi, ku ai i kishte kërkuar e ky i fundit i kishte premtuar.

Jeta e Stresit dhe e gjithë tyre ishte në rrezik, ai si vend për strehim e mendoj kullën e Kuklës. Lek Balsha si një personazh hero do të mbledh gra, fëmijë dhe do t'i dërgon, me qenë se dëshira e tij ishte të qëndrojë në luftë për t'i bërë ballë armikut. Është e rallë kjo që shihet, ku Lek Balsha me kundërshtim të madh i bënë Strezit sepse në asnjë moment ai nuk do të largohet nga ajo luftë. I gjithë ky skenar do të përfundojë me festimet që bënin turqit në qytetin e Beratit, e pikërisht në kala. Edhe pse era e keqe kaploi vendin nga gjaku që kishin ra dëshmorë shumë njerëz, por brohoritjet e tyre nuk do të mungonin, kufomat e tyre do i mbledhin dhe do i groposin, ndërsa të shqiptarëve s'kishte kush t'i mblidhte përveç Strezit i cili gjeti Marashin të vdekur për ta dërguar në Dukagjin ashtu siç kishte kërkuar ai.

Ishte humbje e madhe për shqiptarët, me qenë se kjo humbje nuk do të ishte aq e dhimbëshme sikur të mos i vij pas edhe tradhëtia e Moisi Golemit. I mbetur vetëm Gjergj Kastrioti sepse lidhja e princave do të prishej, italianët do të mbrojnë interesat e tyre, Moisi Golemi do të largohet, mirëpo Skënderbeu kurrë nuk do ta braktis popullin e tij. Pas takimit në Lezhë, Lek Dukagjini tërhiqet, Skënderbeu i mbetur pa ndihmë, i vjen një klithmë nga shpirti ku u thotë: “do shembemi e do të mbulohemi në muret e kështjellave tona, por nuk do të bëhemi kurrë skllevër të lumtur”. Ky lajmotiv i bën që shqiptarët të mblidhen nga të gjitha viset, dhjetë nga dhjetë, ose njëqind e nga njëqind drejtë Krujës, pa u ndërprerë me ushtarë të rrinjë, dhe me një qëllim të përbashkët. Ky motiv për luftë dhe paqe do të zotëroj edhe tek personazhet të cilët ishin kundërshtarë në mes veti, siç janë: Strez Piroli me Zoguan, biseda e tyre merte kahje tjetër për lirinë e vendit, në luftë ka edhe humbje edhe fitore dhe duhet pranuar ashtu siç ndodh.

Kur jemi tek liria e vendit populli shqiptarë harron gjithçka, siç haroi Zogua në momentet kur sheh plagët e Strezit të marra nga lufta, sjell ilaçin më të mirë për t'ia shëruar. Ky gjest siç na e përcjell poeti në roman dëshmon ndërgjegjen e pastër që pati populli shqiptarë për ta mbrojtur me gjak vendin dhe trojet e tyre.

Në kreun e dytë përshkruhet një ndjesi pak më e qetë nga ajo e luftës, udhëtimi i Ajkunës nga Myzeqea në drejtim të Çaf Krrabës. Dyndja e këtyre njerëzve do t'i ç'orientojë sa do

të bien tek fjalët e popullit, ku flitet e përflitet për tradhëtinë e Moisiut dhe humbjen e madhe të Skënderbeut. Aty ndërkohë do të vërehet edhe ndjesia e princeshës Ajkunë ndaj Strez Piroli, me qenë se ai nuk ndodhet përballë saj, por miqësia dhe dashamirsia e tij do të mbizotron në shpirtrat e këtyre personazheve. Dëgjoji për të fjalë të ëmbla dhe të sinqerta nga Martin Ubini i cili pa ndërprerë fliste për lidhjen e tij me Strezin, i tregon cilësitë dhe virtytet që ka ai. Me këto fjalë princeshën Ajkuna e bënte që sa do pak ta harronte pikëllimin e saj dhe të buzëqeshte për fjalët që ja ngacmonin zemrën. Por kush ishte Ajkuna? Përse poeti e shfaq dukshëm ndjesinë e saj që ka për Strez Pirolin? Ishte mbesa e zonjës Mamicë, e cila gjatë rrugëtimit të saj ajo do të mësojë shumëçka për historinë shqiptare, për heronjtë për luftën dhe për Skënderbeun, ashtu vrullshëm ajo do të shfaq interes të veçantë për njerëzit hero, luftëtarë siç ishte Strezi që do të shpreh interes ndjenjash për ta kuptuar më tepër personalitetin e tij. Ndërsa për Strezin kjo vajzë ishte ajo që do t'i ngjasonte Borës. Bora ishte motra e Marashit, i cili vdiq në luftë.

Ky kapitull nuk mbaron me kaq, Strezi do të nisej për në Dukagjin. Nëpër fushat e Tiranës do të ecë një gardë e madhe që vinte nga Kruja për në Qafë Krrabës. Udhëheqësi i kësaj garde ishte komandant Tanush Topia, i cili i drejtonte për në Berat. Në këtë gardë bën pjesë edhe Lek Balsha, Hamëz Kastrioti ne Krujë kishte mbledhur dukagjinast dhe kishte formuar një gardë tjetër të cilën do ta udhëhiqte Strez Piroli (ishte ky vendim që e kishte marrë Gjergj Kastrioti – Skënderbeu), ku edhe thoshte pavarësisht humbjes së Beratit, ai doli fitimtarë e i mbuluar me lavdi.

I tërë vendi filloi të lulëzon nga gardat e ushtrisë shqiptare, Gjergj Kastrioti doli në anën tjetër të vendit, në Dibër, ku mendonte se prej andej i vinte rreziku i madh. Lek Balsha dhe Tanush Topia u nisën për në Berat, prapa tyre u mbledhën shtatë mijë e shtatëqind shpata dhe me helmata të panumërta. pelerina e purpurtë e Lek Balshës ishte e mbushur tërë zjarr e energji, dhe valvitej përsëri mbi shpinën e tij i hipur kalit duke udhëhequr një ushtri.

Tradhëtia

³³Pa mos kaluar në kreun e rradhës do të ndalemi tek e njejta pjesë e romanit, për ta përshkruar tradhëtinë e Moisi Golemit, ndaj Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe gjithë shqiptarëve. Tradhëtia, kjo fjalë me një peshë të rëndë emocionale dhe përcaktimore, pluskon në dallgët e romanit në çaste sprovash, dëshpërimesh dhe humbjesh. Në Berat, në Krujë, Lezhë dhe Oranik. Ajo fytyrëzohet me Moisi Golemin nga familja e Aranitëve që për shërbime, Skënderbeu i kishte dhënë prona të mëdha në Dibër. Ishte njëri nga gjeneralët trima të ushtrisë së Kastriotit. Ushtarët e përbuzin dhe e urrejnë e quajnë Judë i pabesë, tradhëtar, gjarpër. Autori, na jep mendimin e Strez Piroli “ *Tradhëtia,- mendonte Strezi, kështu i ka ndodhur gjithmonë popullit tonë, që nga kohët më të largëta e deri më sot. Sa herë që gjoksi i tij mbushet me shtrëngatën e lirisë, pas shpine përdridhet gjarpëri i reumatizmës së tradhëtisë qi i paralizon shtyllën e kurrizit. Tradhëtia! Ah sikur ta shtypja me dhëmbët e mij kokën e këtij gjarpëri!*”...

Poeti edhe më qartë e konkretizon tradhëtinë e Moisiut me qime të ariut “ u këput një qime nga lëkura e ariut “, nga kjo të bën të kuptosh vlerën e tij që ai pati, sepse ushtria shqiptare ishte e pasur me burra e djem nënash, dhe se ky popull është biri i arianitësve dhe nuk ka vend për tradhëti. Biseda e Martin Ubinit dhe Axlë Vranai të përfytyron një tradhëti të dyshimtë, sepse nuk jepen argumente të para me sy, por ata flisnin vetëm për atë që kishin dëgjuar dhe për këtë ata nuk donin që ta besonin, si një shqiptar vendas, bile as që paramendonin një tradhëti që vinte pikërisht nga një gjeneral siç ishte Moisi Golemi. Por e vërteta e tij doli në realitet, shihet qartë edhe në përshkrimet tjera ku flitet e përflitet për këtë tradhëti që i vjen Skënderbeut nga shoku më i afërt i tij.

Përveç humbjes së madhe, Skënderbeut iu desh që ta përballonte edhe këtë tradhëti, edhe pse nuk e shpërqëndroi nga lufta, ai vazhdoi të mbledhte uhstarë nga të gjitha trevat shqiptare dhe porosinë që ua jepte ishte: “... nuk do të bëhemi kurrë skllevër të lumtur “, nga kjo kuptojmë se Skënderbeu aspak nuk u morr me tradhëtinë e tij, por i vrullshëm për t’iu përballur çfardo lloj sfide që mund t’i vinte.

Etnosi Iliro-Arbëroro-Shqiptar, në udhëkryqet e historisë së tij të lashtë apo moderne shumë herë është gjendur i tradhtuar. Këto tradhti u kanë kushtuar atyre lumenj gjaku dhe

³³ Resmi Osmani, B. Xhaferri, Poeti i shpirtave njerëzorë, Tiranë, 2010, fq.25

humbje të territoreve. Në luftërat Iliro-Romake, mbretëreshën Teuta e tradhëtoi gjenerali i saj Dhimitër Fari në kryengritjen ilire të Dardanisë kundër pushtimit romak tradhtoi njeri nga Batot dhe u hodh me romakët.

Po të vihet re me kujdes, palcën e romanit, forcën që vë në lëvizje, qëndresën shqiptare anti turke, e përbëjnë njerëzit e thjeshtë, malsorët dhe fshatarët e lirë, nga gjiri i të cilëve dalin dhe drejtues trima të devotshëm si Strez Piroli.

E kemi vënë në dukje se duke u zhytur në thellësinë e historisë, Xhaferi, mençurisht ka arritur të kap disa përhershmëri që shfaqen në mënyra të ndryshme dhe në vijimin e kohëve, pavarësisht nga ndryshimi i tyre.

Pas takimit në Lezhë, princat lidhën besë për një fitore dhe se në gardët e tyre nuk do të ketë vend tradhëtia.

Aty prezent ishin Lek Dukagjini Skënderbeu dhe dy nipat e tij Hamz Kastrioti dhe Gjon Stres Bala, ndërsa për t'iu shërbyer edhe më shumë, mori pjesë edhe venedikasi Senator me dy aristokratët e tij. Biseda midis princave kishte për qëllim të mbrojë viset shqiptare meqenëse Lek Dukagjini dhe Hamz Kastrioti kundërshtonin për tradhëtinë që ua kishte bërë Moisi Golemi, mirëpo amaneti i të atit të Lek Dukagjinit ishte, që kurrë mos priset miqësia me familjen e Kastriotëve. Personazhi tjetër që i jep vëmendje të madhe këtij kapitulli është edhe Sokol Igraka, i cili kërkonte kështjellën e Shatit e pastaj t'i bashkohej forcave të Skënderbeut. Në këtë kështjellë futeshin njerëzit pasi shkonin për gjueti të shpendëve në ishullin që ndodhej në Lezhë.

E gjatë kjo bisedë saqë arriti edhe kulmin e natës, mirëpo nuk guxonin ta përhapnin këtë takim për shkak se e gjithë vëmendja e turqve ishte aty. U mundua edhe kryepeshkopi Pal Ëngjëlli që sa më parë të bëhej një takim i tillë për t'i mbledhur forcat në krye me Lek Dukagjinin. Pasi u ndanë nga ky vendtakim, vendosën të kthehen në kështjellën e Shatit. Skënderbeu u kthye edhe njëherë tek familja e tij për ta parë edhe njëherë të birrin e tij të posalindur.

Përveç heroit të madh Skënderbeun, në këtë roman e kemi edhe Strez Sokol Pirolin, i njohur edhe si jeniçer dhe i komandës së gardës së Skënderbeut. Hero mund t'i themi, të cilin, poeti e vë në dukje thujse në çdo kapitull. Heroizmi i tij përfshihet thujse në gjithë veprën, sepse përveç luftës që bënte, ai mundohej t'i ngushëllonte njerëzit, t'i afronte njëri me tjetrin dhe t'i mbronte njëkohësisht, ashtu ndodhi edhe me Borën, ajo meqenëse

e kishte humbur vëllanë e saj, ai u mundua që ajo mos ta kuptojë këtë dhimbje që e ndjente.

Britma e madhe që çau me egërsi qetësinë e mbrëmjes, ishte pikërisht zëri i Strezit i cili po ndalonte kalorsat të cilët kullotnin delet e tyre. Ai shprehi nervozizëm ndaj tyre, duke ua bërë me dije, se kjo tokë është toka jonë nga Perllatët apo të Spanëve. Ishte një ballafaqim i rastësishëm, por që e njohu nga afër se kush ishte ky njeri ! Ishte Stefan Çernovicë. Ky njeri i ardhur nga Mali i Zi, donte që të okuponte disa vende shqiptare, mirëpo beteja e ashpër me Strez Pirolin e detyroi të tërhiqej nga këto troje.

Edhe pse zgjatej kjo luftë e egër në vend, njerëzit patën shumë besim tek Strez Piroli, e pritnin me duart hapur në qytet dhe e përcjellin për në Krujë, meqenëse Kruja që për pesë muaj ishte e rrethuar nga ushtarët e Azisë.

Dashuria është e pranishme edhe në disa faqe të romanit, si ndjenja më e mirë, më e bukur dhe më e thellë njerëzore.³⁴ Të njohurit e tij, dëshmojnë se në moshën e rinisë, autori pati në jetë disa vajza që i deshi dhe e deshën. Mosha e rinisë, pa dashuri është si një pranverë pa lule dhe, jeta pa dashuri është si një vjeshtë e trishtuar. Dashuritë në roman e kanë emrin Ajkuna dhe Eli. Ajkuna është një vashë nga dera princore e Balshajve, mbesë e Skënderbeut. E bukur si zanat e këngëve të kreshnikëve. Rasti dhe fati e takoi me Strezin në ushëkryqin e përgjakur të luftës së Beratit. Ndërsa Ela, shërbetorja jetime e fatkeqe e hanit të kullës Kukle, e bukur, jetime pa mbrojtje, na jepet nga autori me shumë dashuri, tone të hijshme dhe fisnikëri në sjellje dhe marrëdhënie me të tjerët. Ajo dhunohet egërsisht dhe i nënshtrohet pasioneve të një ushtari xheloz e me sjellje të ashpër.

Kjo periudhë lufte ishte tepër e vështirë për to, meqenëse kishin humbur familjarët apo miqtë e tyre dhe aso kohe ata mblidheshin në ndonjë Skëterre pinin dhe vallëzonin, pak sa për t'i harruar plagët e luftës.

Bilal Xhaferi me mjeshtëri të habitshme dhe forcë të madhe krijuese, arrin që në faqet e fundit të romanit të na jep atmosferën, gjendjen e luftëtarëve para betejës, psikologjinë, ankthin e pritjes, padurimin të dhënit pas pijeve në tavernën “ Skëterra “, diskutimet për

³⁴ Resmi Osmani, B. Xhaferri, Poeti i shpirtave njerëzorë, Tiranë, 2010, fq.29

strategjinë dhe taktikën e luftës dhe përgatitjet për betejë.

E gjithë intuita e këtij takimi zbeheshte sepse të gjithë vëmendjen ua merte tradhëtia e Moisi Golemit, pavarësisht ndjenjave që reflektonin dashuri, kjo tradhti bënte që t'i shmangen dashurisë megjithëse ishte vështirë për ta akumuluar ndjenjën shpirtërore që kishin njëri për tjetrin.

Fjalët që qarkullonin lartë e posht për Moisi Golemin gjoja se ka mbledhur gjithë ushtarët e Azisë për t'i sjellur në trojet shqiptare. Për betejën e re, ndaj turqve që do tu printe Moisiu, gjaku shqiptar, i mbledhur nga tërë vendi valonte në Krujë si në një zemër të madhe, Kruja ishte kthyer në kryeqytetin e luftës Napolitanët kishin ardhur në luftë kundër turqve, Hamz Kastrioti me dy mijë burra u hodhën brenda Krujës edhe pse turqit përsëri u treguan më të fuqishëm. Strezi bashkë me Martinin u kthyen nga Dukagjini për në Krujë. Aty mbretërote qetësia, pikërisht në kalanë e Krujës në vendin Krastë ishte e rrethuar nga turqit, gratë shqiptare që mos bien në duart e tyre, rinin mbyllur në atë kala që mban emrin Krastakraus.

Oraniku ishte pragu i atdheut, matanë malit ishte Skënderbeu me njëmbëdhjetë mijë ushtarë, kishin ardhur në fushën e Oranikut, ndërsa tre mijë u shpërndanë nëpër pritrat malore. Shpesh herë aty në fushën e Oranikut që dukeshin si koloseum, ndesheshin nga dy ushtarë si gladiatorë për ta fituar Oranikun. Beteja dallohet nga disa karakteristike që rrëfejnë mjeshtërinë autoriale dhe pikpamjet e tij në rolin e masës dhe të prijësit në luftë. Beteja dhe fushbeteja janë epike duket sikur zhvillohen në një dekor të vendosur midis tokës dhe qiellit, ku lufton gjysëmhehëna me shqiponjën dy krerëshe. Ku përzihen njerëz, kuaj, vringëllima armësh, ku janë të pranishme shtrëngata mugëtira, rrëketë e shiut pishtarët e vetëtimave, furtuna breshëri me shkëlqim verbues, ylberi si një hark triumfi e lavdije. Në këtë sfond gati surreal, ushtarët kacafyten për jetë a vdekje, pellgjet mbushen me ujë e gjak, kuajt kapërcejnë mbi trupat e të vdekurve. Lek Balsha, Hamz Kastrioti, Zuga, Martini të gjithë luftonin me gardën e tyre. Dhe ashtu fuqishëm Strezit iu ngul shpata në shpatull, ku ia ndaloi fuqinë. I gjithë ky epos bëri që personazhet heronj të jenë të pafuqishëm të mbikqyren nga mjekët, dhe të mos kenë fuqi për t'i bërë ballë armikut. Ashtu ndodhi edhe me Strez Pirolin i mbetur me plagët e luftës pa mos patur fuqi të ngrihej as edhe në këmbë.³⁵Fati i këtij luftëtari do të bjerë në betejë për lirinë, duke i lënë si në ëndërr të gjitha strukturimet e tjera të jetës shqiptare të

³⁵ Sabri Hamiti, Letërsia bashkëkohore, Vepra letrare 10, Prishtinë, 2002, fq.379

kohës edhe në këtë roman. Dhe këtu merr fund romani i tij si dhe romani i Bilal Xhaferit. Vetëm mund të imagjinohet si do të zhvillohej figura e tij, të cilën autori e kishte paralajmruar por nuk dinë ta ketë shkruar. Mos do të ishte fati i tij i ngjashëm me fatin e Strezit të tregimit “*Purpuranti*”, që ishte poashtu luftëtar i rojes së Skënderbeut.

³⁶Romani ndërpritet me plagosjen dhe agoninë e Strez Pirolit. Autori nuk na thotë më shumë. Nga historia e dijmë se kjo betejë u fitua dhe Moisi Golemi i mundur u kthye i penduar te Skënderbeu me konop të varur në qafë. Vëllimin e dytë të romanit shkrimtari ose nuk arriti ta shkruajë ose dorëshkrimi iu dogjë nga zjarri që ra në redaksinë e “Krahut të Shqiponjës”.

³⁶ Resmi Osmani, B. Xhaferri, Poeti i shpitrave njerëzore, Tiranë, 2010, fq.24-25

3.3 Analiza e personazheve

³⁷Personazhet janë thuajse të pakët, gati gjysma e tyre na bëhen të njohur që në faqet e para. Janë njerëz të thjeshtë, ushtarë, oficerë, malësorë, por edhe klerikë, vajza të popullit, poet edhe gjeneralë, princër, princesha e fisnikë. Këta personazhe me individualitetet e tyre i mjaftojnë autorit që të paraqesë shoqërinë shqiptare të asaj kohe, me shtresimet shoqërore, psikologjike e morale. Është interesante se si i ka paraqitur dhe tipizuar autori personazhet e veta në funksion të zhvillimit të ngjarjeve dhe ideve që ka dashur të materializojë nëpërmjet tyre. Ata janë të gdhendur si me daltë, me veçori e individualitet të spikatur, që me ligjërimet dhe veprimet e tyre, në vende dhe rrethana të caktuara, të bëjnë të mendosh dhe ti kujtosh gjatë. Të tillë janë: Kryetrimi Gjergj Kastrioti, i nipi Hamza Kastrioti, me fjalën sarkastike e të mprehtë si tehu i shpatës, Strez Piroli.

³⁸Përshkrimi i personazheve duke i lidhur me ambientin, është një prosede i autenticitetit që kap jo vetëm pamjen e jashtme të fytyrës, të figurës, po edhe të karaktereve si të dukagjinave, Strezit, Martin Ubinit e të Lek Balshës; poashtu edhe të jugorëve, si Zugua, në rradhë të parë. Strez Piroli oficer i dalë nga një familje malësore dukagjinase, personazh kryesor i romanit. Trim guximtarë, vetëmohues, besnik, që lufton fort dhe dashuron fort, por që di ti vërë prita kur duhet pasioneve dhe ndjenjës së dashurisë. Ndjenja e detyrës dhe e nderit e bën që të lërë mënjane për një kohë tjetër që do të ishte lumturia e tij. Megjithatë i përfshirë në luftëra ku gjaku derdhet lum dhe trupi i mbulohet me plagë, në përpjekje mbinjerëzore ku shuhet jetë njerëzore, ku jetën një fill e ndanë nga vetja, atij nuk i thahet shpirti, por mbetet njeri me botë të pasur, bujarë me shpirt të ndjeshëm e të dhimbsur, që vuan dëshpërimisht me një dhimbje ulëritëse humbjen e jetëve të njerëzve të tij të dashur, që di ti vlerësoj, të dashuroj, dhe të urrejë, që shkon drejt rrezikut përballë armikut.

Skënderbeu edhe pse fikisht shfaqet në kreun e tretë, me emrin, bëmat dhe lavdinë e tij është i pranishëm si një jehonë, si shpirt i luftës dhe i qëndresës shqiptare. Autori e përshkruan si një njeri i zakonshëm, i dëshpëruar nga përparsitë e fatit, tradhtitë, intrigat dhe dredhitë i merr përsipër si një vepër të madhe. Duke e ditur se lexuesi ka formuar një stereotip për portretin nga paraqitjet e shumta të Skënderbeut në artet figurative, autori nuk merret por gati e

³⁷ Resmi Osmani, B. Xhaferri, Poeti i shpirtave njerëzorë, Tiranë, 2010, fq.17-18

³⁸ Sabri Hamiti, Vepra letrare 10, Letërsia bashkëkohore, Prishtinë, 2002, fq.379

shmang përshkrimin e portretit dhe pamjen e kryetrimt, por me disa detaje, tërësore atë që lexuesi nuk e di por që e shfaq në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kur një ushtarë i Arianitit, pyetet nga vasha e tij (Eli) se si është Skënderbeu, ai përgjigjet “ si një luftë “. Një fjalë e vetme por një simbol i fuqishëm.

Lek Dukagjini ishte princ i disa trojeve shqiptare, dinte t’i ruajë interesat e principatës së tij, prandaj edhe u tërhoq nga lufta, fati dhe liria e vendit ishin në rrezik, ai duhej të zgjidhte midis jetës dhe vdekjes, shpresën dhe guximin apo disfatizimin, barbarisë që vinte nga shkretëtirat e Azisë.

³⁹Hamza, i shëmbëllyer për herë të parë te “ Krastakraus “, mishëron binshëm një karakter njerëzorë të ndërlikuar, princ, ushtarë agresiv, që mendon t’i arrijë ambiciet për pushtet e lavdi me dhunë e kërcënime i privilegjuar nga shkalla shoqërore, e , për këtë edhe përbuzës e hakmerës, i guximshëm dhe inteligjent, i bindur e i pabindur ndaj të ungjit, i ndjerë i përkëdhelur dhe i cënuar.

Martin Ubini, ushtarë dukagjinas që shoqëronte gjithmonë Strez Pirolin, i ndërtuar me eshtra të forta, i ngjeshur me mish të shëndoshë, i mbërthyer e i shtrënguar me muskuj të fuqishëm. Thënë shkurt poeti e konkretizon njëlloj si toka e dukagjinit.

Marashi, djaloshi biond sykaltër i hishëm dhe elegant, burri i zonjës Mamicë, që vritet dhe i derdhet gjaku në zallishtet e Osumit në Berat, njeriu i cili vlerësoi atdheun me jetën e tij. Gjergj Pelini, më tepër mendimtar iluminist e filozof, se sa klerik.

Ajkuna nga dera e Balshajve si princesha e këtij vendi. E bukur si zana e këngëve të kreshnikëve. Rasti dhe fati e takoi me Strezin në udhëkryqin e përgjakur të luftës së Beratit.⁴⁰

Ajkuna dashurohet tek Strezi aq sa është e gatshme të shkoj me të sërish në luftë, po u plagos ajo do t’i mjekojë plagët, po të vdiste ajo, ai do ta varroste me dy duart e tij. Edhe pse familja e saj nuk e pa të arsyeshme këtë lidhje sepse Strezi vinte nga fisi i Pirolëve dukagjinas ndërsa Ajkuna vinte nga një derë princërore.

Zonja Mamicë ishte një grua me profil krenarë, me buzëqeshje engjëjllore të një njeriu të lumtur, që i ngjanë buzëqeshjes së mëngjesit, me shtegun e flokëve si shtegu i pyllit në pranimin e dritës së hënës. Ku kjo dritë do t’i zbehet shumë shpejt kur do ta kuptojë vdekjen e burrit të saj.

³⁹ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 3, Romane, Tiranë, 2010, fq.12

⁴⁰ www.zemrashqiptare.com

Ela, shërbetorja jetime e fatkeqe a hanit të kullës Kukle, e bukur e cila përfaqëson vajzat e vegjëlisë, të popullit. Poeti e përshkruan plot me ngjyra e hijeshi, që kujdeset për ushtarët si një motër. Fisnikria dhe ndjeshmëria është pjesë e karakterit të saj.

Bora si protagonistja e dytë kryesore e romanit, sillet si motra e dashur e Strezit. Bora emër i bukur që rrezaton si drita, e dashur, fisnike, e ndjeshme që vuan dhe përjeton me dhimbje mallin për të vëllanë i cili humbi jetën në betejën e Osumit. Brenga e saj e bëri që ta humbte bukurinë e saj. Me zë drithërues kur pyeste për vëllain, e ndjente në shpirt humbjen e tij megjithëse kujtimi për të nuk do t'i shuhej kurrë.

Mollos Baderi ishte njëri nga ushtarët që i shoqëronte dy princeshat dhe kujdeseshte për to gjatë rrugëtimit. Ai i njihte rrugët e atij vendi ka duhet shkuar për të mos u përballur me turqit. Ai njihte mirë edhe të kaluarën qindëvjeçare.

Lek Balsha, një djalosh që rrinte në rradhët e kalorsave hipur në doriumin e ri. Pamja e tij dukej e butë dhe jo i egër për në luftë, djalosh i ri i bukur me sy të kaltër, me flokë të verdha si të argjendta, lëvizjet e tij eëegante, me një trup të derdhur, shtatlartë që i printe gardës së Strez Pirolit, me pelerinë të purpurtë që simbolizon një ushtarë të fortë.

Sokol Igara, njëri nga kapedanët e një kështjelle në Kashpjet.

Gjon Balsha është i madh dhe me ndjenjë të fortë, i ngjan një lumi që nuk ndalon përpara gjerdheve e pendave, ishte njeri që nuk duronte fjalime të kota, i guximshëm, trim dhe i etur për luftë.

Mark Arusha i cili bënte ligjet në Dukagjin, ishte njeri plak që i kërkonte llogari Strez Pirolit për djemt e vendit, qëllimi i tij ishte të mos largohen ata me larg se porta e Dukagjinit, dhe ta ruajnë kufirin e saj. Ky plak i cili kishte luftuar në Barnat më 1379 nën udhëheqjen e Gjergj Balshës së dytë kundër boshnjakëve dhe në Akrenami më 1400 me Gjin Beun kundër grekëve. Kishte përvojë nga lufta dhe dinte që dërgimi i djemve të tyre në dobi të një vendi të huaj nuk sillte asgjë, vetëm mandate.

Për sa i përket personazhve në tregimet e tij, përgjithësisht mungojnë hyrjet, tregimet nisin si një bisedë e lënë përgjysëm, ngjarjet rrjedhin qetë dhe natyrshëm, bile mungojnë konfliktet e ashpërta. Veprimet e personazhve dhe rrëfimi i ngjarjeve zhvillohet jashtë mjediseve të

mbrendshme, ata janë të pa qetë, janë në kërkim të lumturisë. Personazhet ai i gjenë në kantiere, në minierat, ata janë ndërtues rrugësh, urash, minator të thjeshtë banor të qytezave të largëta. Pa dallim të shtresave të njerëzve fshatarë apo malësor Bilali i përshkruajti me një⁴¹ Ai nuk është konceptuar me njerëzit e rinj dhe as për njerëzit e rinj, siç deklamonte titulli. Për më tepër, deklamimi nuk ishte në stilin e tij, por janë heronjtë me tipare e virtyte të përjetshme e sidomos tipare e virtyte shqiptare. Ashtu ndodh në tregimin “ Në rrugë “ kemi të bëjmë me një personazhë që tregon kavalerizmin e tij, që e lë punën e vet për t’i shoqëruar nëpër fshtrat veriore dy vajzat të njohura rastësisht.

Tek tregimi “ Purpuranti “ protagonist kryesor e kemi një emër të njohur, të përsëritur, që mund të thuhet edhe si vazhdim i jetës së Strez Pirolit. Njeri i ndezur, bujarë, trim dhe atdhedashës i cili irezistoi rrugës së luftës nga gjiri i Drinit deri në Ulqin. Po të shohim rrjedhën e personazheve Epiroti Ergysi dhe Dardani Alkald, dy drejtues ushtarak të kryengritjes kundër romakëve të cilët dashurojnë të njejtën vajzë, Amardën e bukur si një lule e maleve të Dardanisë. Ergysi si personazhi kryesorë i veprës i cili po kthehej nga fushbeteja i lodhur e i raskapitur, i urritur por me një moral të lartë siç i kishte hije një ushtari ilir. Pamja e tij serioze e bëri që të futet në shpellën e një plaku të huaj që të hajë dhe të çlodhet. Përveç personazheve hero në luftë kemi protagonistin që është hero në familje Sejdiun, i cili mban në supet e tij ngarkesën familjare meqenëse i ati i kishte vdekur. Safua një çupëlinë pothuajse fëmijë niset për në formacionin partizan bashkë me të vëllanë, nga që e kishin fejuar me një djalë që ishte ballist, me shumë vështërsi ia dolën kalimit të lumit dhe bënë përpjekje me gjermanët të arrijnë tek partizanët. Dashuria ideale dhe e shenjtë vëlla-motër është tradicionale sepse sakrifikojnë njëri për tjetrin.

Harizi i pa familje, tani është militant në fjalë e në veprime, madje duke tretur vullnetarisht individualitetin, flet në shumës (ne), si zëdhënës i idesë së kolektivitetit. Natyrishtë Harizin e shohim si hero dhe ai u shpëton armiqve, arrinë me frymën e fundit të miqtë e ideve.

Në tregimin “ Dallëndyshje e furtunës “ personazhi tregon rrëfimin e tij personal në vetën e parë, ai me një shpirt dhe ndjenjë të pastër kujton të kaluarën e tij me shumë sfida, por që qëndroi besnik ndaj gruas së tij. Ishte ky fati i një minatori që u ndëshkua jeta e tij nga njeriu më i afërt siç është miku, ose babai i gruas së tij. Në vazhden e personazhëve romantik e kemi

⁴¹ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 2, Romane, Tiranë, 2010, fq.11

edhe tek tregimi “ Largimi “, virtyti i mirë i një punëtori kantier ndëgjonte me vëmendje udhëzimet e një mjekje i cili ishte i djegur duke punuar. Zëri i saj e bëri atë që të harrojë plagët dhe të zhytet në shpirtin e saj. Por e vërteta e këtij protagonisti doli ashtu hapur kur dëgjonte me vëmendje fjalët e mjekes, të ashpërta dhe u dëshpërua, dhe ashtu dëshpërueshëm i kaloi edhe jeta e tij.

Shkrimtari nuk i harroi pa mos i përmendur edhe nxënësit e asaj kohe Alemin dhe Dritën, ata ishin dy nxënës që ishin me një klasë që rrinin bashkë, hulumtonin për gjuhët e huaja dhe pikturonin. Prirjet e tyre ishin më tepër për reportazhë dhe piktorë, domethënë ishin këto prirje që kishin nxënësit shqiptar që atëherë.

⁴²Heronjtë si Serijani të romantizuar, janë shëmbëlltyra të njerëzve, të punëve të vështira fizike, të ndershëm e të singertë me të cilën ai punonte dhe jetonte. Romantizmi i tyre është edhe poetizim dhe idealizim i të ngjashmëve me të, i klasës së tij shoqërore.

Sadetja dhe Ilmiu shprehin një botëkuptim ndryshe nga personazhët tjerë. Të hamendur nga dashuria, duke mos patur eksperiencë në dashuri, ata frikësohen njëri me tjetrin dhe i tradhetojnë ndjenjat e tyre. Ilmiu një djalë punëtor, i bujshëm dhe fizoarmonik i cili dinte ti bij këtij instrumenti muzikor, arriti të ngacmonte ndjenjat shpirtërore që i silleshin vajzat vërdall.

Në tregimin “ Reportazh i vogël “ personazhin që e zgjedh poeti është një djalosh që kishte punuar në kantiere. Ai vendosi një ditë t’i kthehet botës së lapsit. Vendim ky që e mori ai vetë por që nuk dinte kah t’ia niste, kështu që më mirë i dukej të punonte në kantier se si reportazh.

Sa do e vështirë jeta e këtyre personazhëve poeti i kishte si një ëndërr të shkruaj për jetën e bëmat e tyre që e ushqente shpirtin e tij, me shpresë. Ai arriti t’i përshkruaj njerëzit me pamje të bukur, me ideologji moral dhe vizionarë. Ata kishin dhunti që i shfaqin edhe në natyrë njerëz të ndershëm krenarë megjithëse ishin të shkelur nga një klasë shqiptare. Ishin human dhe kishin ndjenjën e dashurisë. Në këto tregime mungon ai që quhej hero negativ që ishte mbartës dhe burim i kontradiktës, vendin e tij e zënë nocioni i së mirës dhe së keqes si pjesë morale e jetës

⁴² Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 2, Romane, Tiranë, 2010, fq.12

3.4 Ngjarja

Ngjarjet në veprën “ Krastakraus ” zhvillohen në periudhën kur vendi ynë ishte në një diktaturë. Kjo vepër përshkruan ngjarje të vërteta, të cilat kanë ndodhur e janë përjetuar.

“ Krastakraus “ lirishtë mund të themi se është roman historik sepse është marë nga epoka e Skënderbeut. Pasi braktisi perandorinë osmane më vitin 1443 ai u kthye në Krujë në vitin 1444 morri komandën e ushtrisë arbërore. Një luftë e cila zgjati 25 vjet nën udhëheqjen e tij. Kjo kohë lufte për shqiptarët ishte sa tragjike aq edhe dramatike. Ndryshe nga autorë të tjerë, Bilal Xhaferi ka zgjedhur të pasqyroj një fragment të trishtuar të asaj epopeje, është njëra nga humbjet më të mëdha e më të përgjakshme.

Tragjedia ndodh në betejën fatkeqe, në muret e Beratit dhe zallishtet e Osumit.⁴³ Në vitin 1455 mbi 12 mijë luftëtarë shqiptar dhe disa qindra ushtarë të Mbretërisë së Napolit rrethuan Beratin dhe nisën sulmet për marjen e tij, me ndihmën e artillerisë aragoneze.

Sulltani dërgoi forcat osmane nën komandën e Isa beut dhe Hamza beut, në ndihmë të të rrethuarve. Për të mos u diktuar nga luftëtarët arbëror, nuk kaluan nga rruga e zakonshme e Shkumbinit por ndoqën rrugën që të çonte në fushën e Korçës. Forcat osmane i zunë në befasi forcat arbërore. Në krye të forcës së mbetur Skënderbeu la Muzak Topinë. Kjo luftë bëhet si një egërsirë në zallishtet e Osumit, ku prigjet e kufomave dhe të vrarët turq e shqiptarë, kanë mbushur gjithë anën e lumit. Edhe sot në Velabisht të Beratit, buzë lumit, ka një emërvend që në kujtim të asaj kohe që, quhet bregu i varreve.

Skënderbeu nuk morri pjesë në këtë betejë, pasi kishte shkuar në jugperëndim për të penguar ndonjë sulm të mundshëm nga garnizoni osman në Vlorë.

Pse perandoria osmane zgjodhi që ta rrethoj Beratin? Sepse Berati ndodhej në një pozicion të rëndësishëm strategjik pasi kontrollonte shumicën e Arbërisë jugore si dhe rrugët jetike të furnizimit në Maqedoninë e jugut dhe Greqi.

⁴⁴Në roman përshkruhet dy beteja të kësaj lufte: disfata e Beratit dhe lufta e Oranikut. Për betejën e Oranikut, ushtria u mblodh siç mblidhen pikat në rrëqe, siç mblidhen rrëketë në përrenjë e prenjtë në lumenj. Kështu vrapuan burrat çam dhe ata të lumit të Vlorës më 1913 kur shkuan për të mbrojtur Janinën, luftëtarët që çliruan Vlorën më 1920 apo mijëra partizan

⁴³ www.wikipedia.org

⁴⁴ Resmi Osmani, B. Xhaferri, Poeti i shpirtrave njerëzorë, Tiranë, 2010, fq.23

në luftën antifashiste. Është dashuria për atdheun, ndjenja e lirisë së dhunuar e nderit dhe burrërisë ajo forcë fatale që i shpie ata në ndeshjen për jetë a vdekje.

Mbështetja e të dhënave historike, fokusohet në ngjarjet dhe harmonizimin realist e veçanërisht në karakterizimin e brendshëm psiko-moral të personazhëve që e përbëjnë këtë roman realist. Siç janë: kryetrimi Gjergj Kastriot Skënderbeu, nipi i tij Hamzë Kastrioti, Strez Piroli i ardhur nga Dukagjini ë krye me Lek Dukagjinin dhe Muzak Topia. Këtu kemi të bëjmë me disa personalitete të shquara të asaj kohe, por që kanë ngelur edhe sot e kësaj dite hero të asaj lufte, meqenëse secili prej tyre përbënin principatat e tyre, përsëri Berati do të okupohet nën perandorinë osmane.

Kjo epokë që mund t'i themi epoka Skenderbejane e mbushur me beteja, e humbje të jashtëzakonshme, dhe e mbështetur në një qëndresë të jashtëzakonshme arrinë të shkëlqej edhe pas kësaj ngjarje.

Lek Dukagjini i ardhur nga veriu i vendit, Skënderbeu me nipin e tij Hamzë Kastrioti që mbronte kufijtë e Dibrës, ndërsa Muzak Topia ishte i pranishëm në betejën e zallishteve të Osumit. Ishte ky një trekëndësh i bërë qëllimisht për t'i mbrojtur trojet dhe viset shqiptare.

Në këto topose shqiptare zbulohen anë të ndryshme të realitetit shoqëror, ku Skënderbeu jepte besimin e tij se qëndresën duhet ta ruajmë deri në fund, pavarësisht humbjes që pësuan. Por ky veprim nuk ndoshi tek të gjithë princat, Moisi Golemi ishte njeri prej tyre që tradhtoi ushtrinë arbërore dhe iu ngjis ushtrisë osmane. Lek Dukagjini për interes të vendit të tij ta ruaj kufirin e dukagjinase, u largua me paramendim që të mos i preken tokat amë.

⁴⁵Gjendja e tyre psiko-shpirtërore tepër të trazuara, arsyetimet e gjykimet e këtyre personazhëve u shprehën përmes dialogut zotërues, ashtu edhe me anë të përsiatjeve herëpashershme, ngjeshin edhe stërngjeshin përmbajtjen mendimore dhe emocionale, ndërkohë që disa syresh zbulojnë edhe ndjeshmëritë e tyre armiqësore shoqërore dhe familjare.

U ndeshën së bashku në takimin e Lezhës gjithnjë me të njejtin qëllim, mbrojtja e tokave shqiptare, biseda e tyre herë-herë dominonte kundër një mendimi, duke e konkretizuar tradhtinë e Moisi Golemit, duke e harruar betejën e Oranikut. Ky gjykim vinte si pasojë e humbjes së Beratit dhe tradhëtia e Moisi Golemit. Hamzë Kastrioti i ndërgjegjshëm në

⁴⁵ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 2, Romane, Tiranë, 2010, fq.11

rafshin emocional i kundërvihet Lek Dukagjinit për humbjen e besimit të tij dhe për krenarinë që e shprehte brenda shoqërisë shqiptare.

Në një skenë të vetme në kështjellën e Lezhës, portretizohen figurat më cilësore të kësaj historie që i njohim edhe sot e kësaj dite, Skënderbeu një kryetrim i cili fitoi besimin e popullit dhe jepte kushtimin për një vend të lirë dhe sovran, Strez Piroli që e dha jetën e tij në betejën e Oranikut për çlirimin e vendit, Hamzë Kastrioti me një fuqi bishe që i bënte ballë armikut. Ishin këta trima, palca e ushtrisë arbërore, këta djem nga rradhët e popullit që e mbronin me gjak vendin e tyre sa herë që u vihej në rrezik, qëllimi i tyre i përbashkët ishte të mos jemi skllevër të lumtur por të qëndrojmë të fortë përballë armikut.

Mënyra se si autori e shkruan këtë ngjarje, u spikat në besimin e popullit, ai e dinë se populli beson shumë në historinë e tyre e sidomos tek epoka Skënderbejane. Kjo mënyrë e paraqitjes së figurës së Skënderbeut është bërë qëllimisht për ti rrëfyer lexuesit, se nuk janë cilësitë e rralla e të jashtëzakonshme vetjake, burim i heroizmit, por karakteri dhe qëllimi i luftës, besimi në drejtësinë e kauzës, përfaqësimi i interesave të popullit, sigurimi i lirisë së tij dhe vendosmëria e lufta për t'i realizuar ato. Këtu ishte çelësi i fitoreve kundër një armiku barbar. Lufta e egër që sundoi vendin bëri që shumë shqiptar ta braktisin vendin e tyre për tu strehuar diku ku do të ishin të sigurtë, i tillë ndodhi fati edhe me shqiptarët e Beratit ku iknin nga Berati për në Krujë, por kjo nuk do të thote se turqit e harruan Albashajn, ishin nisur për në Krujë, megjithëse qyteti i Beratit u përgjak, era e keqe kaploi vendin, mjegullat e errëta mbuluan qiellin saqë të jepnin pamje zie e këtij vendi. Vranë mijëra shqiptarë dhe mbetën të plagosur qindra të tjerë, nga moskujdesi që nuk patën, vdiqën edhe ata, sepse shqiptarët që kishin mbetur të gjallë mundoheshin nga t'ia mbathin. Kështjella e Beratit qe mbushur me ushtarë turq, të cilët festonin fitoren e tyre. Ishte kjo periudha më e zyrtë për historinë e popullit shqiptarë në krye me Gjergj Kastriot Skënderbeun që e pësuan këtë tronditje nga armiku barbar. Bëhet fjalë për një periudhë që i ndesh dy figurat legjendare, Skënderbeun heroin e shqiptarëve dhe Sulltan Mehmetin e II që la shumë gjurmë në historinë periudhës osmane.

Duke u zhytur në thellësinë e kësaj historie, nga autori kapim disa momente të cilat shëmtojnë rrjedhën e kësaj epoqe, ku shfaqen dukshëm në këtë Etnos Iliro-Arbëror. Periudhën e Moisi Golemit i cili tërhiqet nga lufta, i bashkohet ushtrisë së Azisë.

Thënë shkurt, shqiptarët nuk qenë vetëm të rrobëruar por edhe të tradhtuar njëkohësisht,

sepse kjo e fundit cungon, prek dhe e shëmtton më shumë këtë histori për të cilën shumë shqiptarë nuk do të donin as edhe të dëgjonin.

E thënë më parë, hapsirat e kësaj lufte ishin shumë të gjëra, por këtë radhë të fokusuar, sipas shenjave gjeografike: Berat, Krujë, Lezhë, Dukagjin dhe Oranik, pikërisht në mjedise të tri dyerve princërore në kufirin jugor të etnisë të cilat përmbledheshin në disa vatra të ngushta publike e familjare. Kulla Albashaj, veranda në kështjellën e Lezhës dhe Oraniku i fushëbetejës i kthyer si një koloseum.

Nga fillimi i romanit dhe deri në përfundimin e tij luftën e shohim se mbizotronte vetëm në disa stinë, vlen të theksojmë se turqit sa do pak e shihnin rrezikun që mund t'iu vijë gjatë periudhës së dimrit. Lufta e lidhur me stinën e verës, vjeshtës dhe në dimër ikin ushtarët turq, autori e korrespondon me atë që thotë: vinë vjeshta bien gjethet, domethënë kemi humbje të madhe të njerëzve, vijnë vera përsëri shfaqen turqit. I tillë ishte fati i atyre njerëzve që e pësuan këtë luftë shumëvjeçare që nëkupton një histori të gjatë shekullore.

Megjithëse veprimet në roman zhvillohen në Berat-Krujë-Dibër, autori bën kujdes që të rrëfej se ajo luftë është mbarëkombtare dhe përfshin etninë shqiptare si një të tërë e të pandarë. Kjo nënkuptohet kur veterani Mollos Baderi rrëfen për luftërat e Gjin beu Shpatës në Artë të Çamërisë, kundër turqëve, serbëve e grekëve si një fillim të qëndresës antiosmane të shqiptarëve. Këtë do që të verë në dukje edhe kur kujton fitoren e Gjergj Aranitit në grykat e Kurveleshit. Në ushtrinë e Skënderbeut vinin nga rradhët e popullit ushtarë e vullnetarë nga jugu e veriu, ngado ku flitej gjuha shqipe.

3.5 Mesazhi

Lidhur me veprën madhështore të poetit “ Krastakraus “, mesazhin më bindës, më të ndërgjegjshëm dhe emocionues e kemi në kushtrimin që na e thotë Skënderbeu, figura më e ndritshme e historisë sonë, e më krenare dhe më e çmuar, ku nëpërmjet një bisede me Lek Dukagjinin dhe Hamzë Kastriotin që patën në Lezhë si fjalë të fundit dhe që mbeti kulmi i kësaj bisede ishte mesazhi që ua bëri ushtarëve dhe që u trashëgua brez pas brezi, ishte thënia: “ *do të shembemi e do të mbulohe mi në muret e kështjellave tona, por nuk do të bëhemi kurrë skllevër të lumtur* “. Besimin që kishte ky mesazh që rahu fort në zemrën e popullit shqiptarë dhe vazhdoi të përsëritet edhe pas vdekjes së tij. Tjetër figurë që jep mesazhin më frymëzues në këtë roman është ai i Gjergj Pelinit, i cili i porosi ushtarët pavarësisht humbjes njeriu gjithmonë duhet të mbajë qëndresën. Qëndresa dhe durimi çanë malet siç thotë edhe një fjalë popullore.

Edhe po të mos ishte dënuar autori, romani nga censura nuk do të lejohej të botohej, ose edhe po të botohej, do të kthehej në brum për karton sepse romani ishte kundër rrymës dhe prirjes së kohës për mitimizimin e figurës së Skënderbeut dhe epopesë së tij që regjimi për ta mbajtur gjallë krenarinë kombëtare. E ndërtoi këtë vepër me qëllim që të jetë sa më afër të përditshmes jetës reale që haset në shumë drama dhe sfida.

Prandaj me veprën “ Krastakraus “ lexuesi shqiptar i kësaj kohe kupton rrjedhshëm historinë e lavdishme që e karakterizon edhe me tradhëtinë e Moisi Golemit, duke pasur parasysh bëmat e saj kuptojmë se një popull që bart më vete një bagazh histori nuk duhet tradhëtuar, por të qëndroj i fuqishëm dhe të vdiset edhe nëse është e nevojshme, vetëm e vetëm t’i del në besë fjalëve që i shprehu Skënderbeu në periudhën më të vështirë të asaj kohe.

“ Krastakraus “ e Bilal Xhaferit ndërton në një vepër artistike, heroizmin dhe ⁴⁶tragjicitetin shqiptarë duke i ikur himnizimit dhe duke iu afruar rrafshit të jetës së zakonshme, për ta parë atë në nivelin e lidhjeve të përditshme njerëzore dhe ekzistenciale. Kështu që heronjtë e tij letrar edhe pas një mitizimi, në kujtimet kolektive të shqiptarëve dalin bashkëkohas, të zakonshëm, me lakmitë dhe dëshmitë njerëzore. Këto mitizime në një vepër të artit ishin të tmershme për kohët e reja mitzuese, shqipëtare apo për kohën e padrejtësisë që heroizmin

⁴⁶ Sabri Hamiti, Vepra letrare 10, Letërsia bashkëkohore, Prishtinë, 2002, fq.370

nacional e kishin perde për të mbuluar realitetin e zyrtër njerëzor. Prandaj klithja etnike e Bilal Xhaferit në romanin e tij është edhe më e fuqishme, ku jep mesazhin e plotë për kohën që i ka tejkaluar mitet, ndërsa në krijimet tjera do të jenë si pengesë. Në përgjithësi në veprat e Bilal Xhaferit vihet re një sistem karakteristik i dallueshëm, për nga teksti dhe poezia situatat e tekstit të tij janë dramatike në esencë, por jo në paraqitjen grafike, ai bëri përpjekje për t'i shfaqur sa do pak problematikat në rrafshin shoqërorë, meqenëse ju hoq e drejta për t'i publikuar. Por ato si dorëshkrime të tij sjellin vëllën e asaj periudhe diktatoriale. Synimi i tij ishte që vendin gjithnjë ta shihte të lirë, i hequr nga ai rrjet diktatorial.

Tekstet me tema antologjike që dëshmojnë pjekurinë e veprës së tij, konkretizojnë mbi tragjedinë nacionale. E thënë kështu sepse ai me mjeshtëri të madhe nëpërmjet veprës së tij e krahasoi aktualitetin e ashpër shqiptarë dhe në tekste i mbushi me plot dhimbje.

Siç kemi thënë edhe më lartë Bilal Xhaferi kaloi një jetë të vështirë, pati një fëmijëri të mjerë dhe rini të mundimshme. Punoi nëpër kantieret e veriut, ndërkohë mereshite edhe me shkrime. Ëndërronte që një ditë të jetë poet. E pati të vështirë për ta realizuar këtë ëndërr sepse në vorbuallin e tij letrar spikatej jeta diktatoriale. Mirëpo ai me një mjeshtëri si poet realist, arriti t'i kthej shkrimet e tij si romantike, duke i zbukuruar si dukuri të zakonshme. Me këtë kuptuam se njeriu pavarsisht sfidave që mund t'i hasë nga vendi apo shoqëria që e rrethon, nuk duhej dorëzuar, duhet të sfidoj me jetë për të arritur deri tek qëllimi i tij, e jo të biemi pre e një klase, por të bëhemi ashtu siç na thotë vetja dhe zemra jonë. Se çdo sakrificë ka edhe shpërblimin e vetë.

Tek disa novela të poetit “ Përtej largësive “ tregimi “ Purpuranti “ shtrihet një kohë që ka kaluar shumë shekuj. Shikohet se përshkruhet historia e nisur nga rrënjët e etnisë për ta sjellë një komunikim bashkëkohor me karakteristikat e të tashmes. Ai e quajti lufta e qëndresës që luftuan për liri.

Se ky është mesazhi ideografik i vet autorit, i thënë nëpërmjet mendimeve të Ergysit epirot, stërnipit të Piros, personazhit më të skalitur në këtë novelë; njeriu që e njihte artin, fliste latinishten, luftonte me trimëri e mjeshtëri, dhe dintë të dashuronte me zemër. Fjalët e tij në të vërtetë janë klithjet autoriale të autorit për muzgun etnik ilirik.⁴⁷

⁴⁷ Sabri Hamiti, Vepra letrare 10, Letërsia bashkëkohore, Prishtinë, 2002, fq.371

Shumë prej atyre luftëtarëve janë humbur, vendi është shkrumbuar e rrënuar, por etja për liri nuk është shuar. Në këto rrëfime, humbje-luftë për liri dhe ekzistencë janë palca e ngjarjeve që e përbëjnë tregimin, jeta e vështirë e mbrojtur me mish e me shpirt për tu ringjallur dhe për ta siguruar vazhdimësinë.

Për ta lidhur edhe më shumë mesazhin e këtij poeti, do të përshkruajmë disa vepra që përfaqëson mesazhin në tregimin “ Ti je partizane “, titull i cili të bën kureshtar për të kuptuar patriotizmin e femrës shqiptare që kishte në atë kohë. Edhe pse jeta e vështirë me luftëra dhe jetime, partizanja në fjalë nuk iu frikësua realitetit kohor, me shumë motiv dhe dashuri që kishte për vëllanë e saj ajo i rezistoi lumit i cili ishte ky një lum siç na e përshkruan poeti i turbullt që ndante Shqipërinë në dy pjesë: në anën tjetër të lumit bëjnë pjesë partizanët, kurse në tjetrën ballistët, meqenëse Shqipëria ndodhej në luftë, shqiptarët ishin të ndarë në dy klasë: ballist e partizan.

Safua që qe vajzë shumë e re por që diti ti zgjedh anën paqësore të vendit u hodh bashkë me vëllanë në lum, për ti dalur në ndihmë ushtarëve partizan. Është një veprim i cili duhet të meret shembull për të gjithë kohërat sepse Safua la të fejuarin ballist për t’iu vënë në ndihmë vëllaut dhe vendit, që donte ti sheh të lirë një ditë.

Ndërsa në tregimin “ U këput një yll “ fokusohet jeta tragjike që e përjetojnë partizanët. Sakrificat e tyre bëri që tu flijohet jeta dhe të ndëshkohen në emër të lirisë. Janë këto disa tregime me subjekt nga lufta por që përçojnë mesazhe të forta tek brezat që vijnë pas, sepse rrjedhshëm shihet qëndrueshmëria e këtyre partizanëve që e jepnin jetën për atdhe. Në këtë rast e kemi jetën e këtij partizani, i përshkruar në këtë tregim, ishte i plagosur rëndë rrugës për në spital, i dëgjoi krismat që ia çanin veshin, sa që e mbushën me plot energji. Dhe aty qart shihet atdhedashuria, i shtrirë për vdekje por që nuk përballoi dot armikun t’i bëjë luftë.

Tregimet në vazhdim “ Dallëndyshja e furtunës “, “ Reportazh i vogël “, “ Era shtyn mjegulla “ e disa të tjerë, janë të përbëra me të përditshmen e kohës. Poeti i shfaq personazhet të zakonshëm dhe disi pak naiv, meqenëse jeta e tyre varej nga kantieret që punonin dhe patën mesazhe të ndryshme rreth bisedave të tyre, sepse fati i tyre lidheshte me kohën, ndërsa koha lidheshte me punë. Por që në fund lë të kuptohet se përtej asaj vështërsie që kalonte, në fund kishte lehtësim apo zgjidhje. Prandaj njeriu pavarsisht fatit që mund t’i sjell duhet të ketë besim dhe ambicje për të bërë të lumtur jetën e vet.

Poezia e Bilal Xhaferit herë-herë ndërtohet duke iu drejtuar lexuesit, duke marrë parasysh përherë emocionin.

T'i kthehemi këndit të poezive, poeti shfaq shumë mesazhe nga të gjitha aspektet, por dhe të emocionon dhe të frymëzon për këndvështrimin që sjell dukshëm realiteti shqiptar 60-80.

Por unë do të spikas vetëm disa poezi të cilat ngjallin emocionin dhe risin atdhedashurinë për t'i dalë zot vendit amë edhe sot e kësaj dite.

“ Baladë çame “ që është motërzim i poezisë çame, Kosovë Shqipëri, të cilat në mënyrë delikatese ai diti t'i thurr vargjet lirike për ta shprehur dhimbjen që e ndjente në shpirt. Reflekton diskursin e humbjes vetëm e vetëm për ta kujtuar historinë e popullit të vet dhe pa dashur t'i shoh të ndarë trojet shqiptare. Ai me një fjalë ndërthur poezi për t'i kujtuar se Kosova e Çamëria ishin gjithë Shqipëri.

Motivi i dashurisë apo motive peisazhe kemi edhe në disa poezi të poetit, fjala vjen tek poezia “ Fli “ ku shpreh dashuri ndaj motrës që nënkupton për një ndjesi të pastër që kanë vëlla-motër. Peisazhin dhunti nga Zoti që duhet ta ruajmë dhe të kujdesemi për të.

Ndërsa në poezitë patriotike kemi të bëjmë me ato poezi kushtuar legjendarëve tanë duke nisur nga Skënderbeu, Naimi dhe shumë të tjerë.

Shkrimet e Bilal Xhaferit në përgjithësi flasin hapur për lirinë e vendit i cili njëherë u ndodh në luftë për vite me rradhë nga turqit, më pas u fut në kolapsin e diktaturës komuniste shqiptare. Nga kjo poeti shpreh gjuhën e tij për të treguar se njeriu në vendin e tij duhet të jetë i lirë dhe i lumtur.

Kapitulli IV

4.1 Kritika letrare për veprat në poezi dhe prozë

⁴⁸Në dijet moderne për letërsinë, është i njohur koncepti se, kritika letrare zë fill në piktakimin e tekstit me leximin, pra në prerjen e asaj që projekton lexuesi në tekst me “ rrugën “ që ia “ mëson “ teksti lexuesit.

Kësomënyre, kritika s’ mund të barazohet me leximin në të gjitha shenjat, ajo paraqet kërkim në lidhje me tekstin e me leximin njëherësh, duke pretenduar të mos e favorizoj asnjërin.

Leximi kritik i veprës së Xhaferit edhe i poezisë, nënkupton edhe rivendosjen e kësaj vepre në kohën kur u shkrua, për tu parë në dimensionet sociokulturore të shfaqjes në kohë e të ndalimit.

Kritiku letrar Kujtim Shala formulimin e poezisë së Bilal Xhaferit e nënkupton me dy shkallë përcaktuese (një kritikë dialogjike) : së pari, objekti – Poezia e Bilal Xhaferit; së dyti tipi i kërimit – Një kritikë dialogjike. Kritika dialogjike, këtu, nënkupton kërkimin në tekst, për t’u identifikuar e trajtuar përbërësit e tij në një dialog dinamik ndërmjet tyre, së pari; dialogun me poezinë, së dyti, Tipi i pare është më afër koncepteve të M. Bahtinit.

I dyti, atyre të C. Todorovit. Në kuptimin e pare, kritika dialogjike, si variant i kërimit structural, nënkupton Brenda vetes disa nënvariante kërkimi, si; analizë morfologjike, analizë të motivimit, kritikë të stilit, e cila shenjat stilistike i sheh në lidhje me individin, qoftë edhe me brendinë e personit. Derisa, në kuptimin e dytë, leximi dialogjik nënkupton dy subjekte, pra dhe dy subjektivitete: Autori / Lexuesi.

Ngjarjet në veprën “ Krastakraus ” zhvillohen në periudhën kur vendi ynë ishte në një diktaturë. Kjo vepër përshkruan ngjarje të vërteta, të cilat kanë ndodhur e janë përjetuar nga njerëzit. Shkrimtarët kanë pasur dy portrete.⁴⁹ Njëri është portreti njerëzor, me tiparet e jashtme fizike, trupin, gjestet karakteristike, fytyrën, mimikën, veçanërisht sytë-pasqyrë e

⁴⁸ Kujtim M. Shala, Poezia e Bilal Xhaferit (Një kritikë dialogjike), Prishtinë, 2001, fq.6-7

⁴⁹ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 5, Kujtime, Tiranë, 2010, fq.5

ndjenjave dhe e përjetimeve, here të lexueshëm dhe here të palexueshëm, dhe më kryesorja, bota e brendshme, me cilësitë psiko-morale, botëkuptimin, kulturën, mendimet, idetë, bëmat vetiake dhe shprehitë intelektuale dalluese. Tjetri është portreti i shkrimtarit me tipare krijuese, fantazinë, mënyrën e punës e të krijimit, ndjeshmërinë dhe perceptimin, për thyerjen e botës nëpërmjet subjektivitetit artistik, i cili, më konkretisht e më gjerësisht është në veprën e tij.

Për Bilal Xhaferin dhe veprën e tij, Bashkim Kuçuku tregon se vepra e tij nuk ka qenë e mundur të shkruhej aq sa meriton, por është folë vazhdimisht e gjithandej që kur u shfaq në letërsi dhe deri sot e kësaj dite, në 75 vjetorin e lindjes.

Natyrisht, i nxiste karakteri, sjellja, marrëdhëniet e veçanta, të pëlqyeshme që ndërtonte me të gjithë, e përmbi këto talenti i rrallë i penguar me mënyra të ndryshme⁵⁰.

Vath Koreshi, si një ndër pëlqyesit dhe njeri që e njohu për së afërmi Bilal Xhaferin, shkruan për bisedat që kanë pasur dhe për botimin e fletores të thurura me poezi nga dora e shkrimtarit. Duke i lexuar ata vjersha sikur mu mbush gjithçka me zërat, figurat dhe lëvizjet e një nate të largët vjeshte. Më kapi një emocion i veçantë, duke i lexuar vatgjet e para të poezisë “ Baladë Çame “. Kjo vjershë e parë ka qenë një pejzazh mbrëmjeje me rosa dhe me livadhe ku zbardhnin lulëshqerat si kokrra breshëri. “ Baladën Çame “ e kisha vendosur të dytën. Vath Koreshi kishte mendimin për të sa më shumë bëhej i njohur ai, i mirëpritur dhe i dashur për lexuesin, aq më shumë rritej dyshimi për të.

Sipas Skënder Xhelo, mendimi kritik për Bilal Xhaferin thoshte se ai e përfytyronte Shqipërinë si një shqiponjë, që gjoksin e kishte te Shqipëria e sotme, kurse njërën krah e kishte në Kosovë e tjetrin në Çamëri. Unë e përkraha që në atë moment duke ia përforcuar atij idenë që të mos lindin më kundërshtime të tjera. Në mbledhje u vendos që revista e shoqërisë sonë, Lidhjes Çame të mbante emrin “ Krah i Shqiponjës “. Ky botim pati përkrahje në numrin e pare, u ndihmua financiarisht, pastaj në numrat tjerë përkrahja ishte më e vogël, ndërsa ne kërkonim dy përkrahje: morale e financiare. Nga botimet që bëheshin jashtë, “ Krah i Shqiponjës “ ishte një nga më ekstremet antikomuniste. Ajo e vinte gishtin aty ku ishte plaga. Ajo i tregonte popullit dhimbjet, ajo i tregonte se si duhej çliruar Shqipëria, se si duhej zgjidhur çështja e Kosovës dhe Çamërisë.

⁵⁰ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 5, Kujtime, Tiranë, 2010, fq.105

Për here të pare gazetarja Aida Tuci arrinë të shpjegoj shterueshëm se çfarë ka ndodhur atë pasdite prilli të vitit 1968, në klubin e Lidhjes së shkrimtarëve gjatë diskutimit të romanit “Dasma” të Ismail Kadaresë, duke intervistuar bashkohasit dhe gjurmuar dokumentet arkivore dhe një bisedë me Ismail Kadarenë.

⁵¹Bedri Myftari si njëri nga dëshmitarët e pare të asaj mbledhje në intervistën me Aida Tuci, tregon hapur këtë çështje. Njiheshin si miq të vjetër sepse ishin nga Çamëria. Ai dëshmoi se Bilali ishte një njeri i talentuar dhe se kishte bërë disa shkrime por që nuk ishin botuar, ishte i aftë në biseda, përveç shkrimeve ai punonte nëpër kantiere. U habita kur e pashë tek mbledhja e shkrimtarëve dhe sigurisht kishte ardhur për t’i bë kritikë romanit “Dasma” të Kadaresë: *ky është një roman revisionist, është si ai lisi i kalbur...thotë se grate tona kanë qenë të shtypura e kjo nuk është e vërtetë, sepse grate tona kanë luftuar krah për krah me baballarët, burrat dhe djemtë e tyre, që nga Teuta, Nora e Kelmendit, Shote Galica e zonja Çure. Sa për një moment po të mendojmë se gratë tona kanë qenë të shtypura ne duhet ta pranojmë që jemi bastardë, se nga gra të shtypura vetëm bastardë lindin...*

Për mua, nuk ishte shkrimtar disident, i vetmi krijim disident i veprës së tij është poezia “Gazi 69”. Ai konsiderohej talent në atë kohë dhe unë mendoj se ka qenë i tillë. Ai jetoi 20 vjet në Amerikë dhe jo vetëm që nuk ka krijimtari letrare andej, por edhe nuk bëri bujë si shkrimtarë thotë Bedri Myftari.

Sa për poezinë, ajo është tërësisht jashtë stilit të Bilal Xhaferit.

⁵²Adriatik Kallulli, kritiku letrar, për trgimet e Bilalit i cilëson si kredo të artit letrar, sepse ata ishin arte realiste, pa zbukurime dhe idealizime të jetës. Ai i cilëson si një kredo për një art që ka për themel të vërtetat e jetës sonë, sa do të ashpra qofshin ato. Është njëkohësiht edhe një akuzë ndaj zbukuruesve të artit me qëndizma dhe ojna që e tradhetojnë jetën. Është edhe një shuplakë ndaj artit të porsa lindur zyrtar. Në të njetën kohë edhe një shembull artistik se si mund të reflektohen dukuritë e vrazhdëta të jetës dhe të punës.

“Objekti industrial lart në mal”, Bilali që e krijoi me 150 vargje madhësisht të ndryshme. Është me të vërtetë tregim në vargje sikurse e ka pagëzuar vetë ai. Ka vargje që rymojnë e kumbojnë nga aliteracionet, ka të tjerë që ngjajnë si prozë poetike. Kallulli Bilalin e quajti si

⁵¹ Aida Tuci, Rreth dosjes Bilal Xhaferi, Tiranë, 2014, fq.27

⁵² Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 5, Kujtime, Tiranë, 2010, fq.129

art që buron nga e vërteta e jetës.

Bilal Xhaferi polemizon në poezinë “ Ç’na duhen vargjet si karamelle “ me trajtë të përgjithshme kundër artit ornamentalist. Sipas Adriatik Kallullit, përshkrimet e autorit thekson elegancë dhe bukuri mozaike, nuk i shtojnë kurrfarë vlere artit kur mungon e vërteta e jetës. E vërteta artistike e jetës kërkon sy të kapësh, kërkon jetë ta përjetosh. Bilali kishte edhe aftësinë vizive për ta kapur atë, edhe moralin krijues për ta dashur dhe transmetuar atë.

⁵³Sabri Hamiti e quajti poet të nemun sepse si poet çam, e kishte të hapur e të përshërshme plagën për Çamërinë, atë e këndoi ai në tri variante: *Baladë çame*, *Natë çame*, *Janinë*, *Vjeshtë*. Këto janë artikuluar si një kujtim i gjallë si dhembje për shpronësim,shpërngulje me dhunë, çatdhesim të popullsisë çame, që siç do të shihet më vonë do të jetë edhe fati i prerë i autorit.

Për poezinë *Baladë çame*, Sabri Hamiti jep mendimin se kjo poezi jep një dëshmi e një tragjedie kombëtare, ai e quan një vepër e përsosur arti që artikulon njësoj fuqishëm dramën kolektive dhe ankthin individual të saj. Për poezinë *Lamtumirë Çamëri* e quan si një hyrje dhe mbetje në një humbje; një përshëndetje e përkundërt me përshëndetjen mirupafshim, që të jep ndërgjegjen tragjike kombëtare.

Ndërsa tek dy poezitë *Natë çame*, *Janinë*, Bilali e përkujton historinë çame e shqiptare dhe përumbet në hije aty përmbysset tjetërsohet dhe vdes si një identitet kulturor dhe etnik.

Poeti i dhembjeve etnike nuk mundet pa Kosovën, edhe kur ai është jugor dhe kur Kosova jeton vetëm në fantazinë dhe brengën e tij njerëzore dhe poetike, ai me emocionet e forta e pasionet përvëluese bëhen më racional e kthehen në shqiptim të njohjes apo për njohjen me Kosovën duke i artikuluar shenjat e identitetit të saj gjeografik, etnik e historik. Prandaj, kjo poezi del më shumë një katalog i njohjes së tij dhe i fantazisë së tij, sepse poeti i kontakteve të forta emocionale nuk i ndërton ndryshe figurën e të adhurarës që është në rrezik, por nëpërmjet fantazisë që pritët ashpër nga realitetet. Për Bilalin Kosova është me ndarje gjeografike, me ndarje dhe ndarje etnike; rrafsh i lashtë i Dukagjinëve, ai i këndoi Kosovës si tokë e misrit, e lulemollës, po edhe me male kreshnike dhe krahëshqipesh.

Ndryshe nga poet i nemun, Sabri Hamiti Bilalin e quajti poet original, me shpërthime të

⁵³ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Veptra letrare 5, Kujtime, Tiranë, 2010, fq.159

veçanta figurative, që lindën vetëm njëherë, vetëm në një situatë psikologjike krijuese dhe nuk mund të përsëriten më, as te ai as te të tjerët. Ai është një lirik i lindur, që krijon tekstin poetik të ngjeshur me emocione pa asnjë mbetje e kursim. Ai është edhe një poet që ka shkruar pak poezi, po prej tyre pesë a gjashtë pa të cilat nuk do të ndërtohet antologjia e lirikës bashkëkohore shqipe. Ai është një poet etnik, sepse në kohën kur kori i poetëve në Shqipëri rindërtonte dhe farkonte në vargje ideologjitë e përbotshme në botën shqiptare, shpërtheu me temat shqiptare dhe me gjuhën e figurës poetike të autenticitetit.

4.2 Mjeti satirik – Sarkazma

Kur ironia merr një karakter të hidhur, sulmues, kur shpreh urrejtje dhe përbuzje të thellë quhet sarkazëm.⁵⁴ Këtë mjet të fuqishëm e përdorin shpesh poetët në veprat satirike ose oratorët në ligjeratat e veta, kur duan të demaskojnë e të goditin rëndë kundërshtarët, veset e të metat e ndryshme të një shoqërie klasat shfrytëzuese, parazitët e ndryshëm etj.

Këtë figure artistike përdor edhe autori në tregimin “ Errësirë e ndriçuar “ me protagonistin kryesorë Harizin, i cili tallej me gjendjen e atëhershme të udhëhequr nga Ahmet Zogu dhe me të kaluarën e tij. Autori nëpërmjet Harizit i thumbon krerët e vendit, të cilët sipas tij vendin e shihte si qorrsokak.

Tallja që vinte nga Harizi, ai u ndodh në një dhomë tek xhaxhai i tij pa një fotografi të varur në murrë, aty ishte fotografia e Ahmet Zogut, pikërisht në atë moment i lindi ironia për të. Dhe për këtë ironi edhe do ndëshkohet. Ashtu drejtpërdrejt i erdhi kur pa mizat mbi atë fotografi dhe tha: *mizat kanë më shumë guxim se sa njerëzit*. Kjo lloj ironie kaq e drejtpërdrejt në sy të të gjithëve na bën për të qeshur edhe neve si lexues për shkak të guximit të tij, dhe se si i krahason njerëzit apo udhëheqësit me insektet, dhe qëndrimi i tij mbeti shumë serioz. Këtu duket edhe humori i hollë i autorit ku nëpërmjet reagimit të Harizit shumë serioz tregon autoritetin e tij, por që e bën edhe më qesharak në sytë e të tjerëve. Harizi edhe pse u dënua nga kjo lloj tallje, atij përëri i vinin në kokë ironi të tjera ndaj pushtetit, sepse shteti përsëri u trashëgua nga një diktator tjetër.

Pas studimeve i kthyer në shtëpinë e xhaxhait pas shtatë vite mendoj se gjendja e këtij vendi kishte ndryshuar, por si do të reagoj ai kur do ta sheh varur në murr tjetër fotografi dhe fytyrën e xhaxhait të tij. Poeti haptazi përshkruan se njerëzit e pushtetit në fund mbesin pa hijë. Vetëm me fytyrë të plakur dyfish dhe me dhëmbë të prishur të cilët mbetën edhe duarkryq.

Të mbetur ashtu por fotografitë e varura në murr nuk mbanin mbretin Zog por e kishin zëvendësuar me Hitlerin gjerman. Kjo ironi e fatit nuk vjen si pasojë e perëndisë por si pasojë e vetqeverisjes duke mos ditur ta çmojnë atdheun.

⁵⁴ www.google.com - sarkazmë

Në një tjetër tregim siç e quan poeti “ Ave Maria “, titull ky që është emër njeriu por që e gëzonte një kafshë që kishte rolin kryesor në këtë pjesë tregimi. Që nga emir i saj shohim një tallje të ironizuar ku njerëzit punëtor e llogaritnin mushkën si një njeri apo bashkpuntore, që ua sjellte bukën për çdo ditë, dhe njëkohësisht talleshin me të dhe donin që ajo mos të plaket kurrë, ngase ditëve të fundit filloi tu vonohej ushqimi si pasojë e plakjes dhe lodhjes së kësaj mushke, ajo s’mund të ecte si më parë. Poeti përsëri këtu thumbon njerëzit puntorë por të atij pushteti sepse llogaritë nuk i kërkonin nga udhëheqësit e tyte por nga një kafshë e mjerë e cila ishte e pafajshme dhe se ishte plakur që për çdo ditë duke ua sjellë ushqimin.

Ky regim që vjen nga njerëzit punëtor ndaj mushkës Maria ishte ironia që nuk e vlersonin kafshën dhe njerëzit. Kjo figurë artistike nuk ka për qëllim të thumboj vetëm njerëzit e thjeshtë por me anë të kësaj autori godet fort tek të gjithë sistemet e asaj kohe, tek të gjithë pushtetarët, burokratët dhe hierarkistët.

4. 3 Krahasoni i dy veprave të Bilal Xhaferit

Bilal Xhaferi edhe pse e shkruajti me ngut romanin “ Krastakraus “ për vitin jubilarë të 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, mbeti në sirtaret e shtëpisë botuese në Tiranë dhe u botua në vitin 1993, pas vdekjes së autorit.

Kjo vepër jo se përfshinte realitetin e asaj kohe kur jetoi poeti, por përshkruheshte humbja e Beratit, pikërisht në kohën e Skënderbeut. E titulluar “ Krastakraus “ emër vendi në Krujë. Subjekti i veprës është zhvilluar dukshëm në trojet shqiptare duke përfshirë Shqipërinë e madhe etnike e pa kufijë. Ngjarja paraqitet shumë afër me historinë përmes portretizimit të figurës legjendare të Skënderbeut, ai mbështetet në të dhënat e njëmendëta shoqërore të asaj epoke.

Ai me mjeshtri të madhe e realizoi këtë vepër, sa që lexuesit mbetën shumë të kënaqur. Meqenëse në subjekt përfshihet lufta e ashpër, gjakderdhje, humbje, ata e ndjenin si të freskët këtë histori dhe emocionohen nga ky shkrim.

Hapsirat që përfshinte lufta në këtë roman ishte Berati, Kruja, Oraniku, në krye me princat Skënderbeun, Lek Dukagjinin dhe Hamzë Kastriotin. Kjo luftë e cila zgjati 25 vjet me Perandorinë osmane, por që në fund arriti edhe të korë fitoren e saj.

Ky roman ka kapur momente dramatike të rënies së Kalasë së Beratit që ka qenë humbja më e madhe për shqiptarët. E vë në dukje këtë moment, është se poeti kap momentin më esencial në këtë periudhë, pikërisht: qëndresën e popullit.⁵⁵ Qëndresa është një karakteristik jo vetëm e atyre viteve, por e tërë historisë mijëvjeçare të popullit tonë, të cilit, ashtu siç është dashur të qëndrojë e luftojë në fushën e luftës , ashtu është dashur të qëndroj, sidomos atëherë kur e ka humbur luftën, duke provuar me këtë qëndresë vitalitetin e tij, kurajën dhe burrërinë e tij, durimin në kushte të rënda të të munduarit dhe dëshirën e tij të ligjshme për të jetuar i lirë në vendin e tij.

Në fillim të romanit lufta nis si jehonë, dhe mbaron me një atmosferë të pakët. Poeti si kryepersonazhë zgjedh Strez Pirolin, i cili mbledhte ushtarë nga Dukagjini, ndërsa më tepër vëmendje i jepte zonjës Mamicë dhe princeshës Ajkuna, me të cilën Strezi ka rënë në dashuri gjatë përcjelljes nëpër shpatet e udhët malore, pas betejës së Beratit.

⁵⁵ www.google.com – Ra Berati

Nëpërmjet tyre, zonjës Mamicë he princeshës Ajkuna, poeti tregon mesazhin e disfatës duke i rezistuar rrugës nga Arianitët e deri në Muzakienë. Personazhë të tjerë në këtë vepër që i japin rëndësi në tre kapitujt e fundit janë Lek Dukagjini, Skënderbeu, Hamzë Kastrioti, të cilët me principatat e tyre u munduan ti mbrojnë trojet shqiptare. Edhe pse kjo histori e trishtë mbetet në historinë e popullit shqiptarë, Bilali e fut si element kryesorë edhe tradhtinë e Moisi Golemit, gjë që e njollosi këtë histori dhe e bën që ta kujtojmë si akt më të shëmtuar ndaj legjendarit Skënderbeu.

Përveç këtyre Bilali me një mjeshtëri të madhe bëri përshkrimet e natyrës, aq të bukura artistike, i lidhi stinët me luftën, e krahasoi vjeshtën me popullin e Beratit, si shkoj vjeshta, ashtu u humbën njerëzit e këtij vendi.

Romani përfshihet në ngjarjet që u ndodhin personazhëve kryesorë në hapsirën e dy betejave të mëdha: të Beratit dhe të Oranikut, ku Strezi plagoset e vdes në mes shokëve me shpirt krenarë se fati e shpërbleu, duke e bërë ushtarë e oficer të Gjergj Kastriotit, e duke i dhënë një vdekje siç i ka hije burrave. Virtyti më i lartë për meshkujt ishte trimëria.

⁵⁶Nga fundi i romanit Bilali na tregon se si vendi mblidhte e përmbledhte fuqitë për ti qëndruar shtrëngatës që afrohej. Arbërit tani më shkojnë drejt Krujës, jo se i detyronte lidhja e princave, por sepse u thërriste ky element i ri i vetëdijes. Beteja e Oranikut mbetet në faqet e fundit të romanit, nuk ka rëndësi, se historikisht ajo u bë disa vjet para Beratit, kjo betejë duhej fituar, përndryshe do të kishte një mundje përgjithmonë, një shterim përgjithmonë.

“ Krastakraus “ është një vepër e shquar poetit e cila jep përmasa të mëdha nëpërmjet gjuhës së artit, tablon e një epoke nga më të madhërishtet e më heroike të historisë kombëtare.

Për sa i përket romanit të dytë është motërzim i romanit “ Krastakraus “, tani më me titull të ri “ Ra Berati “ të cilën shtëpia botuese Rilindja pati mundësi ta nxjerrë më 1995 me iniciativën e kushërirës së poetit Ballkiz Halili, e cila e ruajti me shumë vështërsi një kopje të dorëshkrimit të romanit dhe me mbështetjen e mikut të tij Shefki Hysa, këtë vepër arritën ta nxjerrin në dritë pas regjimit komunist.

Te “ Ra Berati “, fjala kryesore është folja **Ra**. E vendosur në fillim, veprimi i rënies është befasi e me që nënkupton një rënie nga tradhëtia, pra nga e papritura, e pa menduara, ajo

⁵⁶ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 5, Tiranë 2010, fq.215

mund të krijojë edhe asosacionin e humnerës, që është një rënie e pa kuptuar. Me këtë vëllim poeti e përfshinë edhe motërzimin e Prishtinës, sikurse mund të cilësohet jo vetëm si aty në redaksinë e Rilindjes, por edhe se aty u botua për herë të parë.

Në përmbyllje të motërzimit të dytë, heroi, Strez Piroli nuk plagoset për vdekje, por i grah burrërisht Kolonës Rezervë, nga trupat më të forta të Skënderbeut, në një betejë që parashenjon fitore lavdimadhe.

Ky ndryshim i titullit është mjaft domethënës, gjithpërfshirës, me brendinë që bart në vete kryeqendrën e romanit.

Në këtë vëllim tregimesh “ Njerëz të rinj, Tokë e lashtë “, flitet për njerëzit puntorë të thjeshtë, minatorë, fshatarë, përfshihen djem e vajza të reja, në asnjë tregim nuk është se poeti fut regjimin e asaj kohe, por thjeshtë tregon jetën e Shqipërisë të cilën e zbukuron me pjesët e natyrës. Në fakt autori e anashkalon realizmin që e pëson ky popull, regjimin komunist për vite me rradhë. Ndrshe nga romani “ Krastakraus “, ai vërtet fliste për jetën në vepra industriale, i përshkruante tiparet fisnike të malsorëve, bujarinë, ndershmërinë, atdhedashurinë e tyre që binin në sy te tregimi “ Largimi “, “ Në rrugë “, “ Dashuri dhe fate “. Por trajtimi artistik i këtyre tipareve që krejtë i ndryshëm nga shumë tregime të botuara deri atëherë, një pjesë e të cilave vuanin nga skematizmi.

Ndërsa në tregimet me temë historike ose lufte përsëri poeti do të shfaq elementin e qëndresës duke mos ikur nga ajo që e kishte thënë te romani Krastakraus. Tregimi “ Purpuranti “, “ Përtej largësive “, i pari lidhet me kohën e Skënderbeut kurse e dyta me kohën e kryengritjeve të mëdha ilire në fillim të epokës sonë. Ky orientim, jo vetëm tematik kah toka e lashtë është edhe kërkim i identitetit etnik shqiptar dhe do të bëhet qendra e intresimit krijues të këtij autori edhe në veprat e mëvonshme. Novela “ Përtej largësive “ rrëfen për fundin e kryengritjes së madhe ilire kundër Romës. Në qendër të thurjes së novelës është raporti ndërmjet jetës njerëzore dhe shërbimit luftarak atdhetarë, që e kundërvë dhe e përthyen përfundimisht ndjenjën e jetës personale e të dashurisë me ndjenjën e lartë morale të mbrojtjes së atdheut, të lirisë e të ekzistencës.⁵⁷

Në disa tregime tjera të këtij vëllimi siç kanë motivin e natyrës, poeti ekspozon peizazhin e bukur të Shqipërisë, shumë ngjyrëshe, delikate, tërheqëse me bagëti e bujqësi. Një peizazh

⁵⁷ Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 5, Kujtime, Tiranë, 2010, fq.173

total shqiptarë me përrua të pashtershëm të cilët rridhnin nëpër male e fusha të vendin arbëror. Duke mos i haruar breglumet, qiellin e hapur me hënë plotë që shëndriste nëpër dritaret e punëtorëve minatorë.

Në vëllimin “ Njerëz të rinj, Tokë e lashtë “, krahas romanit Krastakraus poeti shfaq vizionin e tij për të ardhmen, ndërkohë që flet për kohën që ai jetoj.

Ndryshe nga romani në këtë vëllim shohim rrëjtë e autorit, duke i kushtuar me një novelë të titulluar “ Vajza nga brigjet e lumit Kalma “, është një himn i kushtuar Çamërisë, është më e mira, më e bukura nga të gjitha, më e pasura nga të gjitha duke i theksuar qumështin, ullinjtë, mjalti, delet e Çamërisë, përrallat e Çamërisë, të gjitha këto janë të pakrahasueshme prej viseve tjera. Pa mos e harruar pjesën tjetër të Shqipërisë, ai fut në tregimin “ Përtej Rajcës “ që bisedohet për fshatin Kalishtë i ndosur në Strugë të Maqedonisë, ishte pjesa strategjike e poetit për ta shtrirë hartën e frymëzimeve të tij në tërë hapsirën etnike.

4.4 Vërtetimi i hipotezave

Hipoteza 1: Nga ajo që lexuam kuptuam se Bilal Xhaferi ishte poet shumë i rëndësishëm në krijimtarin letrare shqipe, ai me shumë sakrific u mundua ta tregoj realitetin e hidhur shqiptar nga shekulli i kaluar ku udhëhiqeshte nga një diktatur e egër komuniste, mbase edhe nuk e lejuan të botoj veprat e tij për të cilat flet me bindje se jeta e atëhershme ishte e vështirë dhe nuk posedonin të kenë të drejtat dhe vizionet për t'i realizuar mbrenda teritorit shqiptar.

Hipoteza 2: Bilal Xhaferi ishte një shkrimtarë i rënjëve të etnisë në vitet gjashtëdhjetë, disident në Shqipëri, me shumë vështërsi ai do të shkruaj shkrime për vendin e tij. Regjimi i egër komunist ia ndaloj të drejtën e botimit të shkrimeve të tij dhe me arratisjen në SHBA, ai përsëri do të kontriboj në letërsinë shqipe nëpërmjet revistës “ Krahuri i Shqiponjës “.

Hipoteza 3: Edhe pas gjithë pengesave nga ai regjim, Bilal Xhaferi do të vazhdojë të shpreh potencialin e tij krijues duke e pasuruar edhe më shumë letërsinë shqipe me tekste e poezi, megjithëse i dalin në dritë veprat mjaft vonë, pas vdekjes së tij.

4.5 Përfundimi

Në përfundim mund të themi se, veprat e Bilal Xhaferit janë një thesar i vërtetë, plot me vlera. dhe përbëjnë një material shumë të vlefshëm për t'u analizuar dhe për t'u diskutuar.

Personazhet e Bilal Xhaferit janë sa të çuditshëm aq dhe të zakonshëm, sa tragjikë aq edhe komikë, sa të thjeshtë aq edhe madhështorë.

Ky punim diplome është një përpjekje modeste për të dëshmuar edhe njëherë se Brenda formësimit aktual dhe praktik të shenjave gjuhësore shihet një botëkuptim i caktuar i cili shpreh cilësitë shpirtërore të popullit që e flet dhe se gjuha është një realitet mendësor, kulturor, etnografik, shoqërorë.

Të analizosh sot atë që ka ndodhur dekada më pare përballë së sotmes në historinë e letërsisë shqipe mund të të sjellë një ndjenjë për të thelluar arsyet e problematikës që i ndodhi poetit nga regjimi komunist dhe mosbotimi i shkrimeve të tij. Në këtë parashtrim kemi synuar të risjellim edhe njëherë vëmendjen e realitetit të hidhur të asaj kohe, që nga këndvështrimet e ndryshme mbi veprat e Bilal Xhaferit sjellin një stil ndryshe nga ajo kohë që shumë vonë ia nxorën në dritë.

Me të drejtë ky autor konsiderohet si një zë i çmuar në enciklopedinë letrare shqipe. Ai është shembull për shkrimtarët që vine pas, edhe pse ishte i përndjekur nga ai regjim për arsye të biografisë personale kur veprat e tij sillnin stile të dukshme në letërsinë shqipe të viteve 60-ta. Veçojmë në këtë punim poetin për të arsyetuar mbi shtysën demokratike dhe ideologjike që përmbajnë këto vepra dhe të cilat duhet të vijnë tek brezat e rinj, për t'i shtyrë ata drejtë një formimi të plotë letrarë. Mendojmë se duhet orientuar kahu studimorë në mënyrë që të mos përfundojë në shkrimet dëshpëruese të njëanshme, por të reflektojnë mbi motivet dhe mënyrat e të shkruarit dhe të gjykuarit të letërsisë sepse prej Bilal Xhaferit njohim letërsinë mirfilltë. Ajo që e bën të qëndrueshëm janë: vlerat e tij artistike dhe antikomuniste, është pasqyrim i skenave të qëlluara për mbarështrimin e temës kryesore.

Bilali edhe pse përndiqeshte ai u mundua të tregohet i realt dhe i besueshëm para lexuesit, ai, përshkruan, çdo detal për Betejën e Beratit dhe tradhtia që i vjen Skënderbeut.

E tregon në këtë formë pa mos e fshehur në roman, t'i bindë lexuesit se historia njeh edhe

tradhtinë, por që e sfidon me qëndresë.

Nga ky roman i Bilal Xhaferit u njohëm me figurën legjendare të historisë sonë, Gjergj Kastriot Skënderbeun, emër me përmasa që çdo brez e ëndërron individualitetin dhe patriotizmin e tij që sundonte në trojet shqiptare. Ai bëri emër dhe famë pikërisht në atë kohë kur vendi ndodhej në rrezik nga perandoria osmane, krijoi principatën e vet që drejtonte fatin e shumë kryengritësve. Ai i rezistoi luftës së Beratit meqenëse kjo në histori njihet si humbje, të gjitha këto i bën për një qëllim të vetëm, për lirinë kombëtare dhe për ta bërë Shqipërinë e pavaruar dhe sovranë.

Në këtë roman shohim edhe personalitete tjera të cilët i qëndruan heroikisht kësaj beteje e ata ishin Strez Piroli, Lek Dukagjini, Hamzë Kastrioti, ku Bilali me përkushtim të madh duke mos ua humbur vlerat e tyre, ashtu siç i njeh edhe historia do t'i vendosë në qendër të vëmendjes duke i bërë edhe si kryepersonazh të veprës.

Në veçantinë e këtij punimi është vlersimi i këtyre heronjëve që mbajtën qëndresën deri në fund bashkë me kryetrimin që nuk është bërë vetëm nga ana e poetit, por ata u vlerësuan edhe nga shkrimtarë tjerë, të cilët u frymëzuan për të shkruar edhe njëherë figurat më historike të kombit shqiptar.

Gjatë leximit të romanit “ Krastakraus “ dhe “ Ra Berati “ vërejmë një motërzim të dyfishtë. Kuptojmë se është e njëjta ngjarje në roman por që i ndryshon vetëm titulli me foljen *Ra*, vërejmë betejën e ashpër që u njohëm edhe më herët si lufta e humbjes, tjetër karakteristikë është edhe qëndresa e femrës shqiptare që poeti e paraqet nëpërmjet princeshës Ajkuna, që është e gatshme të niset për në luftë. Për derisa vendi ndoshej në këtë gjendje lufte, e vetmja shpresë për ta fituar ishte të marrë shpatën në dorë edhe femra shqiptare, ashtu siç kishte bërë më herët mbretresha Teuta, Shote Galica, Nora e Kelmendit.

Nga shkrimet e Bilalit u njohëm edhe me tregimet e tij; meqenëse punimi ynë përmban temën “ **Qarku tematik në prozën e Bilal Xhaferit** “, aty do të shohim tjerë personazhë ndryshe nga romani, tjera tregime që flet për kohën kur jetoj dhe veproi poeti, duke përfshirë edhe me tre tregime “ Purpuranti “, “ Përtej largësive “, “ Largimi “ periudhën Skenderbejane.

Në shërbim të këtij punimi kemi spikatur personazhët që përbënin prozën e Bilalit duke i parë të ndërgjegjshëm, luftëtarë, guximtarë, bujarë, fisnik dhe atdhedashës që kontribonin në tokat shqiptare, dhe që jepnin harmoni në atë kohë kur Shqipëria u ndodh në regjimin komunist.

Sidoqoftë, dy fragmente të romaneve “ Hëna e kantiereve “, “ Trotuare të kundërta “, Publicistika e marrë nga revista “ Krah i Shqiponjës “ si dhe tërë krijimtaria e tij në prozë përfshirë në vëllimin “ Njerëz të rinj, Tokë e lashtë “, janë përmbledhur në vëllimin “ Përtej largësive “ që dëshmojnë se ky poet nuk rreshti së shkruari. Po t’i kishim të plotë këto fragmente, atëherë do të krijonim një pamje dhe më të plotë të talentit të tij. Të nisemi nga fakti se ky talent dëshmohet më së miri në krijimtarinë e tij letrare të zhvilluar në Shqipëri në vitet 60-ta.

Qëllimisht në këtë punim kemi përdorur edhe vargje të poezive së tij, sepse vlera e krijimeve të shkrimtarëve është e padiskutueshme. Dihet mirë se për të qenë poet duhet të meresh së pari me poezi e të kalosh në rrugën e poetit. Ashtu ndodhi edhe me Bilal Xhaferin i cili së pari botoi veprën e parë me poezi të titulluar “ Lirishta e kuqe “, ku në këtë vëllim të poezisë kemi tema lufte, dashurie, pejzazhe etj. Pa mos e haruar edhe pejzazhin e bukur dhe të pasur të Çamërisë tek poezia “ Baladë Çame “.

Në këto poezi shohim edhe klithmën e poetit që e mundon, ku tregon dhimbjen e shpirtit në vargje hapur për Çamërinë, i dëbuar nga ai vend, por që i mbetet gjithmonë në shpirt.

Nga literatura që kemi shfrytëzuar, do të shohim shumë fakte për këtë poet, i cili ishte i ndjekur nga regjimi komunist, dhe se babain ia kishin vrarë gjoja se ka qenë nacionalist. E ëma i vdes që në moshë të re, ai do të ngelet jetim dhe do të arratiset në SHBA, ku atje do ta themelon revistën “ Krah i Shqiponjës “, vetëm e vetëm që të kontriboj në këtë letërsi, më pas edhe do t’ia dëgjin këtë redaksi, shkrimet e tij nuk do të botohen, do të mbeten në sirtarin e haresës, vetëm vëllimi me poezi që u botua shpejt do ta heqin nga dora e lexuesve.

Por me ardhjen e demokracisë në shtetin shqiptarë si jehonë do të lulëzojnë, veprat e Bilal Xhaferit do të marrin përmasat e krenarisë, lufta kundër atij regjimi që do ta nderojnë me medaljen “ *Martir i demokracisë* “ me motivacionin “ *Për përkushtim si publicist e politikan disident në luftën kundër komunizmit e diktaturës, për aspiratat e tij thellësisht kombëtare e demokratike dhe nderi i kombit* “.

Lidhshmëria-historia-letërsia është e pashmangëshme kur flitet për romane të këtij lloji. Përmendëm vetëm disa ngjarje historike të përzgjedhura nga prizmi i këtij romani, që kanë të bëjnë me rrënien dhe ngritjen e këtij populli, në krye me Skënderbeun.

Të gjithë ato fakte i kemi përshkruar kësaj rradhe me gjuhë të njohur nga romani. Kryetrimi, Beteja e Oranikut, Qëndresa, Kështjellat, Kulla e Kuklës, Veranda etj.

Ndërsa një vend të posaçëm në këtë shkrim i është kushtuar heronjëve shqiptarë pavarësisht humbjes ata përballuan luftën vite me rradhë dhe mbajtën qëndresën vetëm për t'i ruajtur tokat e viseve shqiptare.

Proza e tij krahas poezisë e cila meriton studime të thella, dëshmojnë se ky shkrimatër mbetet përjetësisht pranë nesh me forcën dhe vitalitetin e krijimtarisë së tij, me vlera të padiskutueshme.

Duke e analizuar detajishtë qarkun tematik në prozën e Bilalit shpresojmë që janë thënë gjërat më thelbësore të prozës dhe personalitetit të tij, por që gjithsesi kemi lënë hapsirë që edhe studiues të tjerë të meren me të njejtën temë, sepse për Bilalin nuk ka mbaruar të flasësh vetëm në një punim, por që duhet studiuar akoma sepse është si një burim i pashtershëm dhe duhet vlersuar dhe në shumë projekte tjera më madhështore për ta dëshmuar edhe më bindshëm se ishte shkrimtarë disident, i rrallë në vitet e 60-ta.

Bibliografia

- Aida Tuci, *Rreth dosjes Bilal Xhaferi*, Tiranë 2014
- Hamit Xhaferi, *Figura emblematike të shqiptarizmit*, Tetovë 2000
- Kujtim M Shala, *Poezia e Bilal Xhaferit (Një kritikë dialogjike)*, Prishtinë 2001
- Ahmet Selmani, *Poezi dhe individualitete*, Shkup 1996
- Sabri Hamiti, *Letërsia bashkëkohore, Vepra letrare 10*, Prishtinë 2002
- Roland Zisi, *Veçoritë e narracionit dhe përshkrimit në prozën rrëfimore të Bilal Xhaferit: studim monografik*, Tiranë 2001
- Namik Mane, *Diplomacia e botimit, Miku i të gjithëve*, Tiranë
- Mirela Kondi, *Figura të shquara të Çamërisë*, Tiranë 2016
- Agim Vinca, *Fije të pakëputura*, Tetovë 2007
- Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, Pejë, 2011
- Y, Çiraku, *Artikulimi i poezisë së dramës Bilal Xhaferi*, Tiranë, 2011
- Historia e Letërsisë Shqipe. Albas, Tiranë, 2001
- Shefki Hysa, *Bilal Xhaferi – krijuesi shpirtbinak, Vepra letrare 5*, Tiranë, 2010
- R, Ismaili, *Gjuha standarde dhe histori identitetesh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë*, Tiranë, 2002
- Adriatik Kallulli, *Një dorëshkrim i panjohur i disidentit*, Tiranë, 2012
- Bashkim Kuçuku, *Tragjizmi në kontekstin e një letërsie himnizuese, Bilal Xhaferi, Vepra Letrare I*, Tiranë, 2010
- Gjergj Zheji, *Eleonora, Njeriu përballë qenies , Letërsi ekuilibri*, Tiranë, 2001

Literaturë

Libra:

Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 1, Poezi, Tiranë 2010

Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 2, Tregime, Tiranë 2010

Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 3, Romane, Tiranë 2010

Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 4, Publicistikë, Tiranë 2010

Bashkim Kuçuku, Bilal Xhaferi, Vepra letrare 5, Kujtime, Tiranë 2010

Resmi Osmani, Bilal Xhaferi, Poeti i shpirtrave njerëzorë, Tiranë 2010

Linqe:

[www.Ra Berati.com](http://www.RaBerati.com)

www.wikipedia.org

www.zemrashqiptare.com

www.gazetadita.al

www.bulevardionline.com

www.sq.wikibooks.org

www.google.com-sarkazmë

www.bg-bg.com

www.krahuishqiptonjës.blogspot.com

Deklarata e autorësisë

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se kjo tezë e magistraturës përfaqëson punën time origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë, nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruajtura nëpërmjet citimeve. Studimi i kësaj teme është shkruar prej meje, nuk është prezentuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose në pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

V ë r t e t i m

Kandidatja **Selxhane Selmani Ejupi** dorëzoi për redaktim gjuhësor temën e saj të magistraturës me titull: **Qarku tematik në prozën e Bilal Xhaferit**. Tema e saj iu nënshtrua shqyrtimit dhe redaktimit të përgjithshëm gjuhësor. Andaj kam bindjen se ky studim letrar është në përputhje të plotë me kriteret gjuhësore dhe standardin drejtshkrimor të gjuhës shqipe.